



## ***Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut***

Building D, UNMIK HQ Prishtinë/Priština, Kosovo | E-mail: [hrap-unmik@un.org](mailto:hrap-unmik@un.org) | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

# **Raporti vjetor 2010**



## **Parathënie**

2010 ishte viti i tretë i funksionimit të plotë të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut.

Nga shkurti 2010, për herë të parë përbërja e Panelit gjatë diskutimeve nuk ndryshoi që nga themelimi i tij. Kjo, e kombinuar me efektivitetin e procedurave të brendshme të Panelit gjatë mbajtjes së seancave mujore në Prishtinë, si dhe përdorimi i shtuar i mjeteve elektronike të komunikimit, përmirësuan dukshëm rezultatet e tij, të dëshmuar me statistikat e publikuara në këtë raport.

Për më tepër, niveli aktual i bashkëpunimit me UNMIK-un është një faktor tjetër i rëndësishëm pozitiv për t'i mundësuar Panelit shqyrtimin e lëndëve të pazgjidhura në mënyrë të duhur dhe me efikasitet më të madh se në të kaluarën.

Kah fundi i vitit 2010, problemet e shumta lidhur me çështjen e përkthimit të ankesave të parashtruara pranë Panelit nga serbishtja apo shqipja në anglisht, më në fund u zgjidhën. Një përqindje e lartë e ankesave kanë pritur për shumë muaj për t'u përkthyer, në disa raste për më shumë se një vjet. Mungesa e familjarizimit të plotë me këto dosje e parandalonte Panelin të ndërmarre hapa procedural për rastet e tilla ndërsa po zhvillonte strategji të përgjithshme për trajtimin e tyre.

Në raportet e tij të mëparshme vjetore, Paneli, së bashku me organizatat dhe institucionet e ndryshme ndërkombëtare, theksoi nevojën për rritjen e numrit të stafit profesional në Sekretarinë e tij. Kjo mbetet një domosdoshmëri për shkak të numrit të madh të ankesave të paraqitura në vitin 2009, që në atë kohë i befasoi të gjithë, dhe rezultoi me rritjen e numrit të lëndëve nga dhjetëra në disa qindra. Nevoja për staf shtesë është shoqëruar me një numër shumë të madh të lëndëve të pazgjidhura të cilat janë komplekse dhe kërkojnë punë intensive. Ekziston edhe pritja e justifikueshme e ankuesve, si edhe e opinionit të gjerë publik se Paneli do të merr vendime dhe do të shprehë mendimet e veta brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Paneli nuk ka pasur sukses në kërkesën e stafit të rregullt shtesë nga UNMIK-u dhe ka kërkuar ndihmë në këtë aspekt, duke përfshirë edhe mbështetjen financiare, nga qeveritë e ndryshme. Në fund të vitit 2010, këto përpjekje të shumta më në fund u treguan të suksesshme. Paneli mori miratimin për ndihmë financiare nga Qeveria e Suedisë. Si rezultat i bashkëpunimit të shkëlqyeshëm në mes të Qeverisë së Suedisë, Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, UNMIK-ut dhe Sekretariatit të Panelit, Sekretariati së shpejti do të plotësohet edhe me një avokat tjetër. Mirëpo, kjo nuk do ta zgjidhë plotësisht problemin e mungesës së personelit në Sekretariat sepse nevojat tona janë të mëdha, por sigurisht se dukshëm do të rrisë mundësitë e Panelit.

Përkundër këtyre sfidave të vazhdueshme, në vitin 2010, Paneli nxori një sërë vendimesh dhe mendimesh të rëndësishme në disa fusha, që kryesisht lidheshin me çështjet e të drejtave pronësore dhe qasjes në drejtësi. Praktika e zhvilluar gjyqësore e Panelit në këto raste do t'i mundësojë të zgjidhë më shpejt lëndët e ngjashme të pazgjidhura.

Pjesa më e madhe e rasteve të pazgjidhura kanë të bëjnë me pohimet për mungesën e hetimeve adekuate dhe efektive lidhur me personat e zhdukur apo të vrarë. Në vitin 2010, Paneli i përqendroi përpjekjet e tij në shqyrtimin e secilit prej këtyre rasteve dhe në mbledhjen e informacioneve dhe komenteve nga ankuesit. Të gjitha rastet u shqyrtuan detajisht dhe u bashkuan kur kishin të bënin me viktimat e njëjta, me familjen ose me

ngjarjet. Pas këtij shqyrtimi, Paneli ka miratuar një numër të vendimeve për pranueshmërinë e rasteve për personat e zhdukur dhe të vrarë dhe ka filluar hetimin për bazueshmërinë e tyre. Në shumicën e këtyre rasteve, dalin probleme serioze nga shkaku i mungesës së qasjes apo qasjes së pamjaftueshme të Panelit në dosjet e hetimeve të policisë, që zakonisht do të ishin pika fillestare për një shqyrtim të duhur dhe të plotë të këtyre ankesave.

Përkundër këtyre vështirësive, duke marrë parasysh përvojën e vitit 2010, Paneli fillon një vit të ri të aktiviteteve të tij me një optimizëm dhe besim shumë më të madh në mandatin e tij, duke pasur parasysh rolin që duhet ta luaj për sa u përket të gjithë atyre që atij i kanë besuar ankesat si dhe rëndësinë që ai ka për Kombet e Bashkuara.

Kryetari  
Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut  
mars 2011

## 1. Hyrje

1. Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (Paneli), i themeluar përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, të datës 23 mars 2006<sup>1</sup>, ka vazhduar shqyrtimin e ankesave për shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) apo ato që i atribuohen atij gjatë vitit të tretë të funksionimit të tij në Prishtinë, Kosovë. Paneli mbetet mekanizimi i vetëm që merret me shkeljet e të drejtave të njeriut që pretendohet se janë bërë nga Misioni në terren i Kombeve të Bashkuara apo që i atribuohen atij.

Duke ditur natyrën *sui generis* të Kombeve të Bashkuara dhe ndjeshmërinë e trajtimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut që mund t'i atribuohen vet organizatës, Paneli nuk është gjykatë dhe nuk mund të urdhërojë kompensim ose ndihmë specifike. Megjithatë, ai mund të vendosë nëse UNMIK-u është përgjegjës për shkeljen e një të drejte të njeriut dhe, nëse është, mund t'i bëjë rekomandime Përfaqësuesit Special të Kombeve të Bashkuara (PSSP) në Kosovë kur është e nevojshme. Edhe pse Paneli është akoma duke pritur përgjigjet publike për rekomandimet që ia ka bërë Paneli deri më sot, reagimi fillestar nga UNMIK-u tregon se rekomandimet janë trajtuar me seriozitet dhe se Organizata synon të implementojë rekomandimet e tilla kur është e mundshme.

2. Nga fakti se Paneli u konstituua gjatë pjesës më të madhe të vitit 2010, kishte mundësi të arrinte përparim më të madh në procedimin e ankesave se sa në vitin paraprak. Në këtë raport vjetor mbulohet periudha prej 1 janarit 2010 deri më 31 dhjetor 2010, gjatë së cilës kohe Paneli ka mbajtur 11 seanca, ka pranuar 89 ankesa të reja<sup>2</sup>, dhe ia ka komunikuar 60 raste PSSP-së për komentet e tij për pranueshmërinë dhe/apo për bazueshmërinë e ankesave. Gjatë vitit 2010, Paneli miratoi 13 mendime për bazueshmërinë (lidhur me 23 ankesa), konstatoi se 40 ankesa të tjera ishin të pranueshme apo të pranueshme pjesërisht, miratoi një vendim të pjesshëm për pranueshmërinë, shpalli 10 ankesa të papranueshme dhe hoqi 5 ankesa nga lista. Nga numri i përgjithshëm prej 525 ankesave të regjistruara (duke përfshirë mijëra individë), një numër i përgjithshëm prej 66 rasteve janë të mbyllura, kurse pjesa e mbetur prej 459 ankesave janë në pritje për shqyrtim në faza të ndryshme të procedurës.

3. Gjithashtu, në vitin 2010 Paneli dhe Sekretariati patën sukses në sigurimin e financimit nga Qeveria e Suedisë për punësimin e një stafi shtesë përmes një projekti të vogël të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim për të mbështetur Panelin. Shpresojmë se pjesëtari i ri i stafit do të fillojë punën në fillim të vitit 2011 për një periudhë së paku tetë muajshe. Përveç kësaj, Sekretariati dhe Divizioni i UNMIK-ut për mbështetjen e misionit kanë lidhur kontratë për shërbime nga jashtë të përkthimeve jokonfidenciale për të zvogëluar grumbullin e përkthimeve të pakryera.

4. Përveç kësaj, Paneli dhe Sekretariati u mbajtën prezantime studentëve vizitorë të studimeve master nga Qendra Ndër-universitare Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Demokratizim, dhe stafi i Sekretariatit mori pjesë në punëtorinë për gjyqtarët e Kosovës ku u

<sup>1</sup> Bashkëngjitur si shtojcë A.

<sup>2</sup> Vlen të ceket se për shkak të numrit të vogël të përkthyesve në UNMIK, deri në fund të vitit 2009, përafërsisht 123 ankesa kanë mbetur të papërkthyer dhe, rrjedhimisht, Paneli nuk ka mundur t'i shqyrtojë ato.

prezantua mendimi i tyre për lëndët e bashkuara të *Milogorić dhe të tjerët* (të trajtuar detajisht në §§ 48, 69, 72, 78 - 79, 83, dhe 118 - 119 më poshtë) ku u shtruan edhe pyetje.

5. Gjatë periudhës së raportimit, Paneli po ashtu ka qenë temë e deklaratave publike nga organet e ndryshme të Këshillit të Evropës. Më 7 qershor 2010, Komiteti për Çështje Politike i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE) nxori raport për situatën në Kosovë dhe rolin e Këshillit të Evropës, në të cilin u bënë komente për natyrën unike të Panelit<sup>3</sup> dhe ishte baza për Rezolutën APKE 1739 për situatën në Kosovë dhe rolin e Këshillit të Evropës, ku u bënë disa rekomandime specifike lidhur me zhvillimet legjislative që kishin ndikim te Paneli në vitin 2009.<sup>4</sup>

6. Në vitin 2009, kryesuesi i Komitetit për Çështje Politike i APKE kërkoi nga Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), të përgatisë një mendim pasues për mekanizmat për rishikim të përputhshmërisë së akteve të UNMIK-ut dhe EULEX-it në Kosovë me standardet e të drejtave të njeriut. Një mendim i mëhershëm i Komisionit të Venecias i vitit 2004, i dhënë me kërkesën e APKE, kishte rekomanduar krijimin e një Gjykate të Pavarur për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, me një Panel Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut si zgjidhje e përkohshme për “mungesën e një mekanizmi konsistent adekuat për shqyrtimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut” të bëra nga prantë ndërkombëtare në Kosovë në atë kohë, që do të plotësonte akterët tjerë të të drejtave të njeriut në terren, siç është Institucioni i Ombudspersonit, dhe prantë në terren në Kosovë të zyrave të Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.<sup>5</sup> Komisioni i Venecias e publikoi mendimin e tij përcjellës për mekanizmat ekzistues për rishikimin e përputhshmërisë së akteve të UNMIK-ut dhe EULEX-it në Kosovë më 21 dhjetor 2010.<sup>6</sup> Paneli e përshëndet mendimin i cili bën rekomandime lidhur me një numër të kundërshtimeve me të cilët përballet Paneli, dhe ato do t'i merr parasysh në punën e mëtejshme.

## 2. Përbërja e Panelit

### 2.1. Anëtarët e Panelit

7. Dy anëtarët të Panelit, të cilët janë emëruar nga Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut dhe janë (ri)emëruar nga PSSP-ja në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/11, duke filluar nga 1 janari 2009 ishin z. Marek Nowicki (Poloni), z. Paul Lemmens (Belgjikë). Znj. Christine Chinkin (Mbretëria e Bashkuar/Australi) u emërua nga kryetari i

<sup>3</sup>Z. Björn Von Sydow, Raport për Komitetin e Çështjeve Politike të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për situatën në Kosovë dhe rolin e Këshillit të Evropës, më 17 qershor 2010, gjendet në: [http://assembly.coe.int/Main.asp?link=/Documents/WorkingDocs/Doc10/EDOC12281.htm#P22\\_339](http://assembly.coe.int/Main.asp?link=/Documents/WorkingDocs/Doc10/EDOC12281.htm#P22_339), shih veçanërisht §§ 65-68.

<sup>4</sup> Rezoluta 1739 (2010) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, më 22 qershor 2010, gjendet në: <http://assembly.coe.int/Mainf.asp?link=/Documents/AdoptedText/ta10/eRES1739.htm>, shih veçanërisht §12.

<sup>5</sup>Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), Mendimi për të Drejtat e Njeriut në Kosovë: Vendosi e Mundshme e Mekanizmave të Rishikimit, CDL-AD (2004)033, miratuar nga Komisioni i Venecias në sesionin e tij të 60-të plenar (Venecie, 8-9 tetor 2004), gjendet në: [http://www.venice.coe.int/docs/2004/CDL-AD\(2004\)033-e.asp](http://www.venice.coe.int/docs/2004/CDL-AD(2004)033-e.asp).

<sup>6</sup> Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), Mendim për mekanizmat ekzistues për rishikimin e përputhshmërisë së akteve të UNMIK-ut dhe EULEX-it në Kosovë me standardet e të drejtave të njeriut, CDL-AD(2010)051, miratuar nga Komisioni i Venecias në sesionin e tij plenar të 85-të (Venecie 17-18 dhjetor 2010), gjendet në: <http://www.venice.coe.int/docs/2010/CDL-AD%282010%29051-e.pdf>.

Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe është caktuar nga PSSP-ja më 11 shkurt 2010. Paneli zgjodhi z. Marek Nowicki Kryetar në janar të vitit 2008 dhe e rizgjodhi atë në po të njëjtën pozitë në vitin 2009 dhe 2010<sup>7</sup>.

8. Më tutje në tekst janë të dhënat biografike të anëtarëve të Panelit.

9. **Marek A. Nowicki** (janar 2007 – vazhdon) është shtetas i Polonisë dhe jurist i fushës së të drejtave të njeriut. Që nga viti 1987 është anëtar i Odës së Avokatëve të Varshavës.

10. Z. Nowicki ishte Avokati ndërkombëtar i Popullit në Kosovë, i emëruar nga Kombet e Bashkuara nga korriku i vitit 2000 deri në dhjetor 2005. Ai ka qenë anëtar i Komisionit evropian për të drejtat e njeriut në Strasburg nga marsi 1993 deri më 31 tetor 1999, dhe po ashtu ka qenë anëtar i Polonisë i Rrjetit të Bashkimit Evropian të ekspertëve të pavarur për të drejtat themelore, nga marsi 2003 deri në shtator 2006. Në vitin 2005 ai është emëruar nga Komisioni i ministrave si njëri prej kandidatëve për postin e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës.

11. Ai ishte njëri nga “juristët eminentë” të emëruar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës për të vlerësuar gjendjen ligjore dhe atë të të drejtave të njeriut në Moldavi (1994) dhe në Azerbejxhan (1997). Në vitin 1996 dhe 1998, Këshilli i Evropës i ka propozuar të shërbejë si ekspert i të drejtave të njeriut gjatë vlerësimit të përputhshmërisë së sistemit ligjor të Gjeorgjisë dhe të Federatës Ruse me standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ai ka punuar si ekspert i të drejtave të njeriut për Komisionin Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) dhe për Drejtorinë e përgjithshme për të drejtat e njeriut dhe çështjet ligjore të Këshillit të Evropës.

12. Ai ka qenë një ndër themeluesit e Fondacionit të Helsinkit për të drejtat e njeriut në Varshavë dhe kryetar i tij prej nëntorit 2003 deri në shkurt 2008. Ai është anëtar i Këshillit këshillëdhënës të Qendrës ndërkombëtare për mbrojtje ligjore të të drejtave të njeriut në Londër (INTERIGHTS). Z. Nowicki është autor i disa librave dhe i qindra artikujve për të drejtat e njeriut, të botuara në Poloni dhe në vendet tjera. Ai gjithashtu mban ligjërata për të drejtat e njeriut në universitetin “Collegium Civitas” në Varshavë.

13. **Paul Lemmens** (janar 2007- vazhdon) është shtetas i Belgjikës dhe gjyqtar në Këshillin e shtetit të Belgjikës, post ky që e ka mbajtur që nga viti 1994. Ai ka shërbyer në sektorin e Këshillit të shtetit që shqyrton përputhshmërinë e propozim-legjislaturës dhe propozim-rregulloreve me normat më të larta të së drejtës vendore dhe ndërkombëtare, si dhe në sektorin e së drejtës kontestimore të Këshillit të shtetit, e cila përbën Gjykatën Supreme Administrative të Belgjikës.

14. Që nga viti 1986, z. Lemmens po ashtu ka qenë profesor në Universitetin e Leuvenit, ku ligjëron të drejtën ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut. Ai gjithashtu ka ligjëruar të drejtën kushtetuese, procedurën civile dhe atë administrative. Po kështu, ai është autor i një numri librash dhe artikujsh për ligjet evropiane për të drejtat e njeriut. Ai është drejtor belg i Programit evropian të magistraturës për të drejtat e njeriut dhe demokratizim, program evropian ndëruniversitar me bazë në Venedik të Italisë. Z. Lemmens ka qenë anëtar i Komisioni të Belgjikës për mbrojtjen e të dhënave prej vitit 1987 deri në vitin 1997, dhe gjithashtu është anëtar i Komisionit shtetëror për të drejtat e fëmijës që nga viti 2007. Ai ka

<sup>7</sup> Rregullorja e Punës së PKDNJ (HRAP), Rregulla 6.

qenë ekspert i Këshillit të Evropës për studimin e përputhshmërisë të disa sistemeve shtetërore (të shteteve të Evropës qendrore dhe lindore) me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut gjatë viteve 1990-ta. Ai ka qenë eksperti i lartë i Belgjikës në grupin ligjor të ekspertëve të Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRALEX).

15. **Christine Chinkin** (shkurt 2010-vazhdon), anëtare e Akademisë Britaneze, aktualisht është profesoreshë e së drejtës ndërkombëtare në Fakultetin Ekonomik të Londrës dhe profesoreshë e së drejtës globale William C Cook në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Michigan-it. Ajo është anëtare e Odës së Avokatëve të Anglisë dhe Wales dhe anëtare akademike e Matrix Chambers. Ajo është diplomuar në drejtësi në Universitetin e Londrës, Yale dhe Sidneit dhe më parë ka mbajtur poste akademike me orar të plotë në Universitetin e Oxford-it, të Londrës, Sidneit dhe Southampton-it, Fakultetin e Drejtësisë në Nju Jork dhe në Universitetin Kombëtar të Singaporit.

16. Interesimin kryesor znj. Chinkin e ka në të drejtën ndërkombëtare publike, veçanërisht ligji për traktatet, të drejtat e njeriut, duke e vënë theksin në mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të grave dhe organizatave ndërkombëtare, dhe zgjidhjen e kontesteve vendore dhe ndërkombëtare. Ajo është autore e shumë artikujve për çështje të së drejtës ndërkombëtare publike dhe të drejtat e njeriut të grave, e ligjeve Halsbury të Australisë, E Drejta për Marrëdhënie të Jashtme (botimi i dytë 2001), Palët e Treta në të Drejtën Ndërkombëtare (1993), bashkautore e Zgjidhja e Kontesteve në Australi (botimi i dytë 2002), bashkautore e Kufijtë e të Drejtës Ndërkombëtare: Analizë feministe (2000) dhe bashkautore e Krijimi i së Drejtës Ndërkombëtare (2007). Ajo është drejtoreshë e Asociacionit për studime të së drejtës ndërkombëtare. Në prill 2001 ajo u shpërblye me fletëlavdërimin e Shoqërisë Amerikane të së Drejtës Ndërkombëtare për 'kontribut të jashtëzakonshëm në arritjen e diturisë' dhe në vitin 2006 Medaljen e Shoqërisë Goler T. Butcher 'për kontribut të jashtëzakonshëm për zhvillimin apo realizimin efektiv të ligjit për të drejtat e njeriut' (me H. Charlesworth).

17. Znj. Chinkin ka qenë konsulente e së drejtës ndërkombëtare për Bankën e Azisë për Zhvillim; për trafikimin e grave në Zyrën e Komisionerit të Lartë të KB-së për të Drejtat e Njeriut; për Marrëveshjet e Paqes dhe Çështjet Gjinore në Divizionin e KB-së për Avancimin e Gruas dhe për UNIFEM. Aktualisht ajo është eksperte shkencore për një Komision ad hoc të Këshillit të Evropës për hartimin e një konvente për dhunën kundër gruas dhe dhunën në familje. Ajo ka qenë anëtare e Misionit për gjetjen e fakteve për Beit Hanoun, në pajtim me Rezolutën e Këshillit të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara S 3/1, maj 2008, dhe Misionin e KB-së për gjetjen e fakteve në Konfliktin e Gazës në vitin 2009.

## 2.2. Sekretariati i Panelit

18. Sekretariati i Panelit përbëhet prej një zyrtari ekzekutiv, dy zyrtarëve ligjorë dhe dy asistenteve administrative. Më poshtë në tekst janë dhënë informatat biografike të anëtarëve të Sekretariatit që kanë punuar gjatë vitit 2010.

### 2.2.1. Anëtarët e Sekretariatit në fund të vitit 2010

19. **Rajesh Talwar**, shtetas i Indisë, ka punuar për Kombet e Bashkuara gjatë dhjetë viteve të fundit në cilësi të ndryshme në Kosovë, Somali, Liberi dhe Afganistan para se të kthehet në Kosovë për të marrë pozitën e zyrtarit ekzekutiv në Sekretariatit të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut. Para se të punojë për Kombet e Bashkuara ai ka bërë praktikë ligjore në Gjykatën Supreme të Indisë dhe në gjykatat tjera më të ulëta në Indi. Derisa ka bërë

praktikë ligjore ai njëkohësisht u ka dhënë mësim studentëve LLB në Universitetin e Delhit dhe Jamia Millia Islamia gjatë një periudhe gjashtëvjeçare. Si avokat ai ka qenë i lidhur ngushtë me disa lëndë të të drejtave të njeriut duke përfshirë edhe peticionet kryesore që kanë të bëjnë me çështjet që dalin nga HIV/AIDS. Në vitin 1996 ai shkoi në Mbretërinë e Bashkuar me një bursë britaneze Chevening, ku ai përfundoi studimet master në drejtësi (LLM) në Ligjin për të drejtat e njeriut në Universitetin Nottingham. Ai është autor i disa publikimeve, duke përfshirë libra të së drejtës dhe të drejtave të njeriut.

20. **Anila Premti**, shtetase e Shqipërisë, iu bashkua Sekretariatit si zyrtare ligjore në tetor të vitit 2010, një detyrë e përkohshme nga posti i saj i rregullt në UNCTAD të Gjenevës, Zvicër ku ajo ka punuar që nga viti 2004. Më parë, znj. Premti gjithashtu ka shërbyer si zyrtare ligjore në Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut, në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (2007-2009), dhe në Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Çështje Ligjore, Divizioni për kodifikim, në Nju Jork (2001-2004). Para se të fillojë punën në Kombet e Bashkuara, znj. Premti ka punuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë (1995-2001), ku ajo u përqendrua në çështjet ligjore dhe ato të traktateve, si dhe në çështjet e të drejtave të njeriut në kontekstin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe në Këshillin e Evropës. Znj. Premti ka magjistruar në drejtësi në Universitetin Tulane në Shtetet e Bashkuara, dhe është diplomuar në drejtësi në Universitetin e Tiranës, Shqipëri. Ajo gjithashtu ka studiuar të drejtën ndërkombëtare dhe marrëdhëniet ndërkombëtare në Holandë dhe në Mbretërinë e Bashkuar.

21. **Ravi K. Reddy**, shtetas amerikan dhe anëtar i Odës së Avokatëve të Nju Jorkut, iu bashkua Sekretariatit si zyrtar ligjor në maj të vitit 2009. Më parë z. Reddy ka shërbyer si zyrtar ligjor në zyrën e drejtorit të Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut dhe si zyrtar ligjor në Programin e Shteteve të Bashkuara për avokim të Human Rights Watch. Z. Reddy ka kryer magjistraturën në fushën e të drejtave të njeriut në Universitetin e Notinghamit, ka doktoruar në lëmin e drejtësisë në Universitetin e Pitsburgut dhe ka diplomuar në arte dhe histori në Universitetin e Delaveres.

22. **Snezhana Martinoviq** është punonjëse vendore, e cila punon si asistente administrative në Sekretariat që nga dhjetori 2007. Ajo ia filloi punën në Kombet e Bashkuara në vitin 2000, ku ka punuar si asistente administrative në Departamentin e Drejtësisë të UNMIK-ut.

23. **Adlije Muzaqi**, është punonjëse vendore, e cila punon si asistente administrative në Sekretariat që nga shtatori 2010. Ajo ia filloi punën në Kombet e Bashkuara në tetor të vitit 1999 si asistente administrative në Administratën komunale të UNMIK-ut në komunën e Vushtrrisë, rajoni i Mitrovicës.

### 2.2.2. Anëtarët e Panelit të cilët kanë shërbyer gjatë vitit 2010

24. **Nedim Osmanagiq**, shtetas i Bosnjës, iu bashkua Sekretariatit si zyrtar ligjor nga qershori 2009 deri në shtator 2010, ku ishte zyrtar përgjegjës i Sekretarisë dhe ushtrues detyre i zyrtarit ekzekutiv të saj nga qershori 2009 deri në shkurt 2010. Z. Osmanagiq i sjell Sekretarisë përvojën e tij të zëvendës-avokatit të popullit për Bosnjë dhe Hercegovinë, të zyrtarit për të drejtat e njeriut në Zyrën e Komisionerit të lartë për të drejtat e njeriut në Prishtinë, të inspektorit të lartë gjyqësor në UNMIK, të zyrtarit ligjor në Komisionin e Venecias të Këshillit të Evropës, të UNMIK-ut dhe të UNMBIH, të këshilltarit për të drejta të njeriut në misionin e OSBE-së në Bosnje dhe Hercegovinë, si dhe përvojën e UNDP-së në



Somali. Ai u largua nga Sekretaria në shtator për t'ju bashkuar Zyrës së Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut në Kosovë.

25. **Mimoza Arifi-Hoxha**, punonjëse vendore, ishte asistente administrative në Sekretariat që nga nëntori i vitit 2008 deri në shtator 2010. Ajo ia filloi punës në Kombet e Bashkuara në dhjetor të vitit 1999 në cilësinë e asistentes administrative në Divizionin e informimit publik/zyrën e mediave të UNMIK-ut. Ajo tani punon në Zyrën e Prokurorit Special të Kosovës nën Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX).

### 3. Korniza rregullative

#### 3.1. Rregullorja nr. 2006/12 dhe Urdhëresa administrative nr. 2009/1

26. Korniza kryesore ligjore për punën e Panelit mbetet Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, përmes së cilës i jepen autorizimet Panelit për shqyrtimin e ankesave me diapazon të gjerë lidhur me shkeljen e drejtave të njeriut që pretendohet se janë bërë nga UNMIK-u duke u bazuar në instrumentet vijuese: Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve të tjera Jonjerëzore dhe Poshtëuese dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Juridiksioni kohor i Panelit fillon nga 23 prilli 2005.<sup>8</sup>

27. Më 17 tetor 2009, PSSP-ja shpalli Urdhëresën administrative nr. 2009/1 për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut. Urdhëresa administrative në fakt ndryshon kriteret e pranueshmërisë dhe procedurën për procedimin e ankesave, mënyrën e drejtimit të dëgjimeve publike dhe procedurën e caktimit të anëtarëve të Panelit. Gjithashtu rregullon mënyrën e publikimit të komunikatave për shtyp dhe njoftimeve të Panelit. Siguron edhe afatin e fundit për parashtrimin e ankesave pranë Panelit. Urdhëresa administrative është shqyrtuar detajisht në raportin e Panelit të vitit 2009 në §§ 35-45.

28. Procedura e Panelit përbëhet prej dy fazave kryesore<sup>9</sup>: e para ka të bëjë me shqyrtimin e pranueshmërisë së ankesës, ndërsa faza e dytë, nëse ankesa shpallet e pranueshme, me shqyrtimin e bazueshmërisë së saj. Pranueshmëria përcaktohet përmes një vendimi formal, ku ceket edhe arsyetimi i tij. Në disa raste, Paneli fillimisht ka marrë vendim të pjesshëm për pranueshmërinë, dhe më pastaj në vendimin e formës së prerë janë përcaktuar çështjet e mbetura të pranueshmërisë. Vendimet publikohen në faqen e internetit të Panelit pasi të jenë njoftuar palët në procedurë. Nëse Paneli shpall si të pranueshme tërë ankesën apo pjesë të caktuara të saj, pastaj fillon me shqyrtimin e bazueshmërisë së ankesës.

29. Nëse shqyrtimi i ankesës vazhdon me shqyrtimin e bazueshmërisë së saj, Paneli del me një mendim nëse ankuesit i janë shkelur të drejtat e njeriut nga UNMIKU, ku mund të përfshihen edhe rekomandime drejtuar PSSP-së<sup>10</sup>. Pasi t'u jetë dhënë mendimi palëve, të

<sup>8</sup> Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, Neni 2. Shih gjithashtu paragrafin 45, *infra*.

<sup>9</sup> Për përshkrime të mëtejshme të procedurës së Panelit, shih pjesën 4 të këtij raporti.

<sup>10</sup> Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, neni 17.1.

njëtit gjithashtu publikohen në faqen e internetit të Panelit<sup>11</sup>. Nga ky moment, vetëm PSSP-ja ka autorizim për të vepruar apo jo në bazë të gjetjeve të Panelit.<sup>12</sup>

### 3.2. Rregullorja e punës

30. Përveç disa ndryshimeve kozmetike që i janë bërë Rregullores së punës së Panelit (p.sh. zëvendësimi i fjalës “Kryetar” me “Anëtar kryesues”), në vitin 2010, Paneli po ashtu ka bërë disa ndryshime përmbajtësore në Rregulloren e vet të punës, përkatësisht në Rregullën 33, për të qenë në harmoni me disa dispozita të caktuara të Urdhresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 dhe për të përshpejtuar procedimin e ankesave për aq sa është e mundshme.

31. Në mënyrë më specifike, Rregulla 33 § 1 ishte ndryshuar për të përfshirë kërkesat e paraqitura në nenin 2.3 të Urdhresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 drejtpërdrejt në Rregulloren e Punës. Në nenin 2.3 thuhet se, nëse ngritët një çështje e re për pranueshmërinë apo një gjë e tillë paraqitet pasi ankesa të jetë shpallur e pranueshme, Paneli duhet të pezullojë diskutimet për bazueshmërinë e ankesës dhe të vendosë për çështjen e pranueshmërisë me një vendim të veçantë. Mirëpo, në situatat kur PSSP-ja në tërësi ka shqyrtuar bazueshmërinë e ankesës, Rregulla 33 § 2 i mundëson Panelit të vazhdojë me mendimin për bazueshmërinë ku do ta përshijë vendimin e tij për çështjen e pranueshmërisë. Zbatimi praktik i rregullave të reja është diskutuar më tutje nën juridiksionin e Panelit.

### 4. Nismat për informim publik

32. Pas tërheqjes së përgjithshme të UNMIK-ut nga ushtrimi i funksioneve të përgjithshme në Kosovë në vitin 2008<sup>13</sup>, Paneli vendosi të mos angazhohet në ndonjë fushatë të gjerë të informimit të qytetarëve. Me zvogëlimin e përgjegjësive të UNMIK-ut, ka gjasa që më pak ankesa të shpallen të pranueshme, dhe Paneli ka bërë përpjekje t’u ikë rritjes së pritjeve nga ana e ankuesve me inkurajimin e tyre që të parashtrajnë ankesa të reja.

33. Megjithatë, Paneli filloi një fushatë të informimit publik në fillim të vitit 2010, në frymën e nenit 5 të Urdhresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1, e cila parasheh që Paneli më nuk do të mund të pranojë ankesa që do të parashtrohen pas datës 31 mars 2010. Pasi që kjo informatë nuk u bë e ditur në mbarë regjionin, u botuan shpallje në gazetatat regjionale (në *Danas* dhe *Politika* që botohen në Beograd në gjuhën serbe dhe në *Koha Ditore* që botohet në Prishtinë në gjuhën shqipe) për t’u siguruar që qytetarët në përgjithësi të jenë në dijeni për afatin e fundit. Përveç kësaj, dita e fundit për paraqitje ishte shpallur në faqen e parë të uebsajtit të Panelit dhe akoma është e shënuar aty në të tri gjuhët e punës së Panelit.

34. Uebsajti i Panelit po ashtu ka pësuar ndryshime përmbajtësore për të mundësuar pamje (interface) dhe qasje më të lehtë tek vendimet dhe mendimet e Panelit. Në uebsajt aktualisht janë të shënuara vendimet dhe mendimet e Panelit në dy formate të ndryshme. Paneli vazhdon të shënojë lëndët sipas numrit të tyre dhe siguron linqet për të gjitha vendimet dhe mendimet për atë lëndë. Përveç kësaj, tani po ashtu shënon nëse ankesa është akoma në pritje

<sup>11</sup> Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, neni 17.2.

<sup>12</sup> Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, neni 17.3.

<sup>13</sup> Pas deklaratës presidenciale të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të datës 26 nëntor 2008, S/PRST/2008/44, ku mirëpritet angazhimi i vazhdueshëm i Bashkimit Evropian në Kosovë.

për shqyrtim pranë Panelit apo procedura është e përfunduar. Tani Paneli po ashtu shënon çdo vendim dhe mendim të tij në renditje kronologjike, ashtu që opinioni publik të mund të përcjellë zhvillimin e praktikës gjyqësore të Panelit. Për shkak të kufizimeve teknike he për he, kjo u konsiderua si mënyra më e mirë për përmirësimin e qasjes në punën e Panelit.

## 5. Numri i lëndëve në Panel dhe të dhënat statistikore

### 5.1. Të dhënat statistikore

35. Gjatë periudhës raportuese, numri i përgjithshëm prej 89 ankesave u parashtruan para ditës së fundit 31 mars 2010 për parashtrimin e ankesave të reja. Kështu, Paneli ka pranuar një numër të përgjithshëm prej 525 ankesave ndërmjet vitit 2006 dhe 2010, nga të cilat 459 janë në pritje në faza të ndryshme të procedurës. Në fund të vitit 2010, 87 raste ishin në pritje të përkthimit.

36. Gjatë periudhës raportuese, Paneli ka miratuar 13 mendime për bazueshmërinë (lidhur me 23 ankesa), 40 ankesa të tjera i shpalli të pranueshme apo të pranueshme pjesërisht, miratoi një vendim të pjesshëm për pranueshmërinë, shpalli 10 ankesa të papranueshme dhe hoqi pesë ankesa nga lista.

37. Në fund të vitit 2010, kanë qenë 459 lëndë që prisnin zgjidhje nga Paneli, ku 27 prej këtyre lëndëve prisnin mendimin për bazueshmërinë e tyre<sup>14</sup> dhe 432 lëndët e mbetura në pritje të vendimit fillestar për pranueshmërinë.

| <b>Numri i lëndëve, komunikatave dhe vendimeve të PKDNJ-së prej vitit 2006 deri më 2010</b> |             |             |             |                   |             |                 |
|---|-------------|-------------|-------------|-------------------|-------------|-----------------|
| <b>Numri i lëndëve</b>  | <b>2006</b> | <b>2007</b> | <b>2008</b> | <b>2009</b>       | <b>2010</b> | <b>Gjithsej</b> |
| Të pranuar  | 3           | 12          | 69          | 352 <sup>15</sup> | 89          | <b>525</b>      |
| Të mbyllura   | 0           | 0           | 18          | 11                | 37          | <b>66</b>       |
| Në pritje të zgjidhjes  | 3           | 15          | 66          | 407               | 455         | <b>459</b>      |

| <b>Komunikata</b>                   | <b>2006</b>       | <b>2007</b> | <b>2008</b> | <b>2009</b> | <b>2010</b> | <b>Gjithsej</b> |
|-------------------------------------|-------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-----------------|
| Të komunikuar PSSP-së               | N/V <sup>16</sup> | -           | 30          | 71          | 60          | <b>161</b>      |
| Përgjigje nga PSSP-ja               | -                 | -           | 18          | 75          | 30          | <b>123</b>      |
| Në pritje të përgjigjes nga PSSP-ja | -                 | -           | 12          | 8           | 38          | <b>38</b>       |

<sup>14</sup> Në rastet ku kemi mendim të pjesshëm për bazueshmërinë, rasti akoma pret mendimin përfundimtar për bazueshmërinë. Gjithashtu, pas shpalljes së Urdhresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 disa raste që aktualisht presin mendimin për bazueshmërinë kërkojnë një vendim të dytë për pranueshmërinë.

<sup>15</sup> Rastet e pranuar në vitin 2009 dhe që janë ndarë në dy apo më shumë raste u janë shtuar statistikave të vitit 2009.

<sup>16</sup> Anëtarët e Panelit nuk janë emëruar deri në janar të vitit 2007 dhe Paneli nuk ka mbajtur seancën e tij të parë deri në nëntor 2007, andaj është përdorur shkurtesa “Nuk Vlen” (N/V).

| <b>Vendimet: Lloji</b>  | <b>2006</b> | <b>2007</b> | <b>2008</b> | <b>2009</b>     | <b>2010</b> | <b>Gjithsej</b>            |
|---|-------------|-------------|-------------|-----------------|-------------|----------------------------|
| Gjithsej  | -           | -           | 32          | 23              | 78          | <b>133</b>                 |
| Vendimet për pranueshmëri                                     | -           | -           | 28          | 22              | 56          | <b>106</b>                 |
| Vendimet për pranueshmëri të pjesshme                         | -           | -           | 2           | 0               | 1           | <b>3</b>                   |
| Mendimet për bazueshmëri                                      | -           | -           | 1           | 0               | 22          | <b>23</b>                  |
| Mendimet e pjesshme   | -           | -           | 0           | 1 <sup>17</sup> | 0           | <b>1</b>                   |
| Kërkesa për rishqyrtim  | -           | -           | 1           | 0               | 0           | <b>1</b>                   |
| <b>Vendime: gjetje</b>  | <b>2006</b> | <b>2007</b> | <b>2008</b> | <b>2009</b>     | <b>2010</b> | <b>Gjithsej</b>            |
| Vendime: Plotësisht të pranueshme                             | -           | -           | 11          | 2               | 16          | <b>29</b>                  |
| Vendime: Të pranueshme pjesërisht, të papranueshme pjesërisht | -           | -           | (2)         | 9               | 24<br>(1)   | <b>33 (3<sup>18</sup>)</b> |
| Vendime: Plotësisht të papranueshme                           | -           | -           | 17          | 8               | 10          | <b>35</b>                  |
| Vendime: Të hequra nga lista                                  | -           | -           | 0           | 3               | 5           | <b>8</b>                   |
| Mendime: Shkelje  | -           | -           | 1           | 0               | 21          | <b>22</b>                  |
| Mendime: nuk ka shkelje                                       | -           | -           | 0           | (1)             | 1           | <b>1 (1<sup>19</sup>)</b>  |
| Kërkesa për rishqyrtim: Të refuzuara                          | -           | -           | 1           | 0               | 0           | <b>1</b>                   |

## **5.2. Tendencat në numrin e përgjithshëm të lëndëve dhe çështjet e tjera të rëndësishme**

38. Disa tendenca në numrin e përgjithshëm të lëndëve të Panelit kanë mbetur të njëjta, ndërsa të tjerat kanë ndryshuar dukshëm nga periudha e fundit raportuese.

39. Një ndryshim nga periudha e fundit raportuese është se numri më i madh i rasteve të reja të pranuar në vitin 2010 u përqendruan në kontestet e punësimit, duke përfshirë edhe parashtrimin e tri ankesave lidhur me numrin e përgjithshëm prej 6, 559 ankesa që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të pamundësisë për të punuar në ndërmarrjen publike energjetike në Kosovë, ku ankuesit kishin punuar deri në vitin 1999.

<sup>17</sup> Kjo i referohet mendimit të pjesshëm për bazueshmërinë, ku Paneli vendosi një çështje domethënëse substanciale, por shtyri shqyrtimin e mëtejme të bazueshmërisë për një datë të mëvonshme; shih Raportin vjetor të vitit 2009, paragrafin 58 & 85

<sup>18</sup> Numrat në kllapa u referohen vendimeve të pjesshme për pranueshmërinë.

<sup>19</sup> Numrat në kllapa i referohen mendimit të pjesshëm për pranueshmërinë të cilit i referohemi në fusnotën 17, *supra*

40. Sa i përket numrit të madh të lëndëve të paraqitura në vitin 2009 lidhur me pohimin për mungesën e hetimeve efektive për zhdukjet, kidnapimet dhe vrasjet në Kosovë, u bë një shqyrtim i hollësishëm i të gjitha ankesave të pazgjidhura për hetime të paefektshme gjatë verës së vitit 2010, në mënyrë që të identifikoheshin dhe konsolidoheshin ankesat që mund të bashkohen për t'u shqyrtuar nga Paneli. Në fakt, pas këtyre zhvillimeve, Paneli filloi miratimin e vendimeve për pranueshmërinë në lëndët e tilla me seriozitet dhe ka filluar shqyrtimin për bazueshmërinë për shumë raste.

41. Vlen gjithashtu të theksohet se, pas emërimit të anëtarit të tretë të Panelit në vitin 2010, Paneli ishte në gjendje të përfundojë numrin e ankesave të parashtruara në vitin 2007, ku Paneli miratoi mendime për bazueshmërinë ose vendime të formës së prerë për pranueshmërinë në të gjitha lëndët përpos në një ankesë që ishte në pritje për shqyrtim nga viti 2007.

42. Pas miratimit të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1, Paneli ka rishqyrtuar çështjet e pranueshmërisë në disa raste dhe ka miratuar një sërë praktikash për t'i mundësuar atij të përcjellë strukturat e urdhëresës administrative derisa vazhdon me procedimin e rasteve në mënyrë efektive.

43. Përveç rasteve të sipërpërmendura, Paneli vazhdoi me procedimin e lëndëve lidhur me si vijon:

- Pohimet për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë (neni 6 § 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)), e drejta për respektim të jetës private dhe familjare (neni 8 § 1 i KEDNJ), e drejta për mbrojtje të pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ) si dhe e drejta për mjet të efektshëm (neni 13 i KEDNJ), lidhur me vendimet e nxjerra nga Drejtoria për Çështje Banesore –Pronësore dhe nga Komisioni i tij për Ankesa për Çështje Banesore Pronësore, dhe Agjencia Kosovare e Pronës dhe Komisioni për Ankesa Pronësore lidhur me pronësinë dhe zotërimin.

- Pohimet për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë (neni 6 § 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)), e drejta për respektim të jetës private dhe familjare (neni 8 § 1 i KEDNJ), e drejta për mbrojtje të pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ) si dhe e drejta për mjet të efektshëm (neni 13 i KEDNJ), lidhur me largimet e pasuksesshme të uzurpuesve të pohuar të paligjshëm të pronës.

- Pohimet për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë (neni 6 § 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)), e drejta për respektim të jetës private dhe familjare (neni 8 § 1 i KEDNJ), e drejta për mbrojtje të pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ) si dhe e drejta për mjet të efektshëm (neni 13 i KEDNJ), lidhur me pohimet për vendime kontradiktore të lëndëve pronësore në mes të Drejtorisë për Çështje Banesore Pronësore ose Agjencisë Kosovare të Pronës dhe gjykatave komunale e atyre të qarkut.

- Pohimet për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë (neni 6 § 1 i KEDNJ) dhe e drejta për mbrojtje të pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ), lidhur me vendimet e marra nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, përkritazi me përfitimet e punëtorëve që është dashur t'u paguhen përmes privatizimit të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore (NPSH) si dhe pronësia e NPSH-ve.

- Pohimet për shkelje të së drejtës për mbrojtje të pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ), lidhur me konfiskimin e pronës nga autoritetet për zbatimin e ligjit.

### 5.3. Mendimet dhe vendimet e Panelit sipas lëndës për shqyrtim

44. Më poshtë janë shënuar disa raste sipas lëndës për shqyrtim:

#### **E drejta për jetë – E drejta për hetime të efektshme – Ndalimi i torturës dhe trajtimit jonjerëzor apo degradues**

##### Protestuesit e vranë nga Policia e UNMIK-ut më 10 shkurt 2007

- *Kadri Balaj, dhe të tjerët* I 04/07 (vendim i dytë i 31 marsit 2010) – I papranueshëm<sup>20</sup>  
Kosovari i vranë në aksidentin automobilistik me policin e UNMIK-ut jashtë detyre në vitin 2002

##### Rastet e vrasjeve/personave të zhdukur lidhur me konfliktin

- *D.P.* 04/09 (vendim i 6 gushtit 2010) – I pranueshëm
- *G.R.* 12/09 (vendim i 6 gushtit 2010) - I pranueshëm
- *S.C.* 02/09 (vendim i 9 shtatorit 2010) - I pranueshëm
- *J.D.* 44/09 (vendim i 21 tetorit 2010) - I pranueshëm
- *B.A.* 52/09 (vendim i 21 tetorit 2010) - I pranueshëm
- *Živorad Ogarević* 77/09 (vendim i 21 tetorit 2010) - I pranueshëm
- *Nebojša Petković* 125/09 & 126/09 (vendim i 21 tetorit 2010)- I pranueshëm
- *Milko Milenković* 127/09 (vendim i 21 tetorit 2010) - I pranueshëm
- *Z.I.* 145/09 (vendim i 21 tetorit 2010) - I pranueshëm
- *R.P.* 120/09 & 121/09 (vendim i 26 nëntorit 2010) - I pranueshëm
- *Zufe Miladinović* 86/09 (vendim i 16 dhjetorit 2010) - I pranueshëm

#### **Ankesa e personave të zhvendosur brenda vendit në pjesën veriore të Kosovës rom/ashkali/egjiptas**

##### Shih vendimin e 5 qershorit 2009 për përshkrim të plotë të çështjeve të të drejtave të njeriut në fjalë.

- *N.M. dhe të tjerët* 26/08 (vendim i dytë i 31 marsit 2010) – I papranueshëm<sup>21</sup>

#### **Prona – E drejta për posedim të papenguar**

##### TV Mitrovica/Konfiskim i pajisjeve nga Komisioni i Pavarur për Media

- *Nexhmedin Spahiu* 02/08 (mendim i 26 nëntorit 2010) – Shkelje  
Konfiskimi nga UNMIK-u i mallrave komerciale (Municion)

##### Kontest privat lidhur me pronën

- *Jagodinka Dokić* 208/09 (vendim i 16 dhjetorit 2010) - I papranueshëm Ankesa kundër Qeverisë së Kosovës pas 15 qershorit 2008
- *Kolë Krasniqi* 48/08 (vendim i 13 marsit 2010) - I papranueshëm

##### E drejta për gjykim të drejtë – Pronë banesore

- *Momir Jevtić* 07/08 (vendim i 14 majit 2010) - I papranueshëm

<sup>20</sup> Edhe pse ankesa u shpall e papranueshme, Paneli ia la derën hapur një procedure të veçantë për ankuesit që ata të rihapin procedurën për ankesën e diskutuar më poshtë në §§ 64.

<sup>21</sup> Edhe pse ankesa u shpall e papranueshme, Paneli ia la derën hapur një procedure të veçantë për ankuesit që ata të rihapin procedurën për ankesën e diskutuar më poshtë në §§ 64.

**Kontestet e punësimit**E drejta për gjykim të drejtë – Kohëzgjatja e procedurës

- *Gani Emiri* 17/08 (vendim i 18 qershorit 2010) – Shkelje, Shkarkim nga Trupat Mbrojtëse të Kosovës
- *Gani Thaçi*, 13/08 (vendim i pjesshëm për pranueshmëri i 9 shtatorit 2010) – I papranueshëm pjesërisht, pjesa tjetër është pezulluar

Kontest punësimi i ndërlidhur me UNMIK-un

- *Hashim Rusinovci* 43/10 (vendim i 18 qershorit 2010) – I papranueshëm

Kontest punësimi i ndërlidhur me EULEX-in

- *Lulzim Gashi* 11/10 (vendim i 14 majit 2010) – I papranueshëm

**Rastet e Komisionit të Ankesave për Çështje Banesore Pronësore**E drejta për gjykim të drejtë – E drejta për mjet efektiv – E drejta për posedim të papenguar – Ndalimi i diskriminimit

- *Milije Vučković* 03/07 (vendim i 13 marsit 2010) – Nuk ka shkelje
- *Nadica Kušić* 08/07 (vendim i 15 majit 2010) - Shkelje
- *Miroslav Mihajlović* 15/08 (vendim i 16 dhjetorit 2010) - I pranueshëm
- *Simo Mitrović* 06/07 (vendim i 17 dhjetorit 2010) – Shkelje
- *Slobodan Miletić* 07/07 (vendim i 17 dhjetorit 2010) - Shkelje
- *Slobodan Dragojević* 09/07 (vendim i 17 dhjetorit 2010) - Shkelje
- *Vesna Andjelković* 11/07 (vendim i 17 dhjetorit 2010) – Shkelje

**“14,000” lëndët<sup>22</sup>**E drejta për gjykim të drejtë – Gëzim i papenguar i pasurisë – E drejta për mjet të efektshëm

- *Petko Milogorić* 38/08, *Milisav Zivaljević* 58/08, *Dragan Gojković* 61/08, *Danilo Ćukić* 63/08 & *Slavko Bogićević* 69/08 (vendim i 24 marsit 2010) – Shkelje
- *V.Z.* 25/08 (vendim i 18 qershorit 2010) – Shkelje
- *Živko Živković* 28/08, *Božidar Perović* 65/08, *Arsenije Dimitrijević* 68/08 & *Dragiša Aleksić* 40/09 (vendim i 18 qershorit 2010) - I pranueshëm
- *Živko Živković* 28/08, *Božidar Perović* 65/08, *Arsenije Dimitrijević* 68/08 & *Dragiša Aleksić* 40/09 (vendim i 6 gushtit 2010) – Shkelje
- *Esat Beriša* 27/08, *M.R.* 42/08, *Ž.S.* 44/08 & *Slobodan Aćimović* 32/09 (vendim i 6 gushtit 2010) – I pranueshëm
- *Božidar Portić* 62/08, *Novica Ulamović* 30/09 & *Spasoje Martinović* 31/09 (vendim i 6 gushtit 2010) – I pranueshëm
- *Božidar Portić* 62/08, *Novica Ulamović* 30/09 & *Spasoje Martinović* 31/09 (vendim i 9 shtatorit 2010) – Shkelje
- *Tomo Petrović* 59/08, *Obrad Djosović* 60/08, *Dragan Petković* 64/08, *Miodrag Milosavljević* 67/08, *Čedo Ralević* 07/09, *Miljko Ralević* 08/09, *Dragomir Ralević* 09/09, *Milenko Ralević* 10/09, *Simo Ralević* 11/09, *Muharem Ibraj* 16/09, *Muharem Ibraj* 17/09 & *Musa Ibraj* 22/09 (vendim i 9 shtatorit 2010) – I pranueshëm
- *Milka Živković* 29/08 (vendim i 26 nëntorit 2010) - I pranueshëm
- *Dragan Prelević* 11/08 (vendim i 16 dhjetorit 2010) - I pranueshëm

<sup>22</sup> U referohet mijëra lëndëve të paraqitura kundër UNMIK-ut, KFOR-it dhe IPVQ-ve dhe komunave të ndryshme në vitin 2004 për të cilat u pezullua procedura pas shkresës së UNMIK-ut drejtuar gjykatave të ndryshme në Kosovë. Në kohën kur u dërgua shkresa, u referoheshte “mbi 14,000 rasteve” të parashtruara. Në fund, numri ishte afër 17,000 – 18,000 raste.

## **Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit**

E drejta për gjykim të drejtë – E drejta për gëzim të papenguar të pasurisë – E drejta për mjet efektiv – E drejta për të mos u diskriminuar

- *Radovan Parlić* 01/07 (mendim i 18 qershorit 2010) – Shkelje
- *Ranko Vasić* 02/07 (vendim i dytë i 6 gushtit 2010) – I papranueshëm

## **Kundërshtim i dispozitave të Urdhëresës administrative nr. 2009/1**

E drejta për gjykim të drejtë – E drejta për mjet të efektshëm

*Kadri Balaj dhe të tjerët II* 320/09 (vendim i 12 shkurtit 2010) – I papranueshëm

## **6. Praktika gjyqësore e Panelit**

45. Pas miratimit të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1, Paneli u përball me çështje të reja të pranueshmërisë, duke përfshirë edhe inkorporimin e Procesit të Kombeve të Bashkuara për ankesa nga pala e tretë, “një mjet në dispozicion” i dekretuar nga UNMIK-u, dhe me mënyrën se si saktësisht të procedohet me kërkesat ashtu që në çdo fazë para miratimit të mendimit të Panelit mbi bazueshmërinë e ankesës, UNMIK-u të mund të paraqesë kundërshtime të reja për pranueshmërinë të cilat më pastaj do të kërkonin “pezullimin” e shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës. Edhe pse Paneli deri diku ka pasur mundësi të merret me këto çështje përmes ndryshimeve që i ka bërë në Rregulloren e vet të punës (të diskutuar më lart), çështjet tjera mbetën për t’u zgjidhur përmes praktikës gjyqësore të Panelit. Ndoshta ajo çka është edhe më e rëndësishme është se, viti nën shqyrtim e gjeti Panelin duke zgjeruar kompetencën e tij materiale për një sërë çështjesh përmes finalizimit të një numri të mendimeve për bazueshmërinë.

### **6.1. Çështjet e pranueshmërisë**

#### **Rregulla për periudhën gjashtëmuajore**

46. Njoftimi i përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit është njëloj sikurse njoftimi i vet ankuesit me qëllim të ecjes së afatit prej gjashtë muajsh kur ankuesi duhet të parashtrojë ankesë pranë Panelit. Shih PKDNJ, *Ranko Vasić*, lënda nr. 02/07 (vendim i dytë i 6 gushtit 2010).

#### **Juridiksioni kohor (*Ratione Temporis*)**

47. Kur kemi vendim gjyqësor me të cilin refuzohet inicimi i procedurës penale, dhe vendimi i dorëzohet viktimës apo familjes së viktimës, dhe ata nuk parashtrojnë ankesë as nuk ndërmarrin ndjekje penale subsidiare, data kur ai vendim merr formën e prerë tregon kur situata e tillë ka përfunduar, dhe nëse Paneli ka juridiksion *ratione temporis* për të trajtuar ankesën. Në rastin e *Haki Dedës dhe Vahide Dedës*, ankuesit tregojnë se imuniteti i dhënë policit ndërkombëtar të UNMIK-ut i ka parandaluar ata nga ndjekja e mjeteve penale dhe civile kundër atij polici pas përfshirjes së tij në një aksident automobilistik që shkaktoi vdekjen e një fëmije dhe lëndimin e rëndë të një tjetri. Mirëpo, sipas nenit 2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, Paneli ka juridiksion të shqyrtojë vetëm shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut të cilat kanë ndodhur jo më herët se 23 prill 2005 ose që dalin nga faktet që janë paraqitur para asaj date kur faktet e tilla tregojnë shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut. Kështu, që nga koha kur ndodhi aksidenti në vitin 2002 dhe, për më tepër, nga koha kur aktgjykimi i gjykatës komunale me të cilin refuzohej kërkesa për zbatim të hetimeve mori



formën e prerë më 19 janar 2005, Paneli nuk kishte juridiksion *ratione temporis* për shqyrtimin e ankesës. Shih PKDNJ, *Haki Deda dhe Vahide Deda*, lënda nr. nr. 56/08 (vendim i 13 marsit 2010).

48. Siç u tha më lart në rastin e *Haki Dedës dhe Vahide Dedës*, Paneli ripohoi në vitin 2010 se vetëm do të shqyrtojë veprime apo mosveprime që paraqisnin shkelje të të drejtave të njeriut të kryera jo më herët se 23 prill 2005 ose që dilnin nga faktet e paraqitura para saj date kur përbëjnë shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut, ashtu siç është paraqitur në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12, neni 2. Paneli gjithashtu konstatoi se periudha nën shqyrtim do të zgjaste deri në kohën kur kompetencat e UNMIK-ut për ushtrimin e efektshëm të mandatit të tij në këtë fushë pushuan së ekzistuari. Për çështjet që lidheshin me AKP dhe HPD, Paneli konstatoi se periudha e rishqyrtimit përfundoi më 31 dhjetor 2008, kur skadoi Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/50 me të cilën u themelua AKP si pasardhëse e HPD. Shih PKDNJ, *Nadica Kušić*, lënda nr. 08/07 (mendim i 15 majit 2010). Për çështjet që lidhen me administrimin e drejtësisë në Kosovë, Paneli konstatoi se periudha e rishqyrtimit përfundoi më 9 dhjetor 2008 me hyrjen e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) dhe pushimin e autoritetit ekzekutiv të UNMIK-ut në fushën e drejtësisë. Shih PKDNJ, *Petko Milogorić dhe të tjerët*, lëndët me nr. 38/08, 58/08, 61/08, 63/08 dhe 69/08 (mendim i 24 marsit 2010).

### **Juridiksioni *Ratione Personae***

49. Edhe pse lidhet me konceptin e kompetencës *ratione temporis* të Panelit, Paneli konsideron se në raste të caktuara lidhur me ngjarjet që ndodhën pasi UNMIK-u pushoi ushtrimin e pushtetit ekzekutiv në një fushë të caktuar, Paneli nuk kishte juridiksion *ratione personae* për akterët të cilët ishin përgjegjës për aktet e kundërshtuara. Në rastin *Krasniqi*, Paneli mori në konsideratë realitetin politik në terren dhe konsideroi se nga 15 qershori 2008 e tutje, “UNMIK-u parimisht nuk mund të mbahet më përgjegjës për veprimet apo mosveprimet me të cilët ngarkohen autoritetet e Kosovës, thjeshtë për shkak të vazhdimin të ekzistimit të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999).” Mirëpo, Paneli nuk përjashtoi se mund të ekzistojnë rrethana të veçanta që mund të shpijnë në konkludime të ndryshme në raste të caktuara. Shih PKDNJ, *Kolë Krasniqi*, lënda nr. 48/08 (vendim i 13 marsit 2010).

50. Në rastin *Krasniqi*, ankuesi u ankua se moszbatimi i ligjeve të caktuara nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, shpuri në diskriminim të ankuesit. Në shqyrtimin e kompetencës *ratione personae* për trajtimin e ankesës, Paneli u pajtua me argumentin e PSSP-së se, pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës më 15 qershor 2008, dhe duke marrë parasysh raportet e shumta të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për këtë çështje, PSSP-ja nuk kishte mundësi të zbatojë në tërësi pushtetin e tij ekzekutiv me të cilin akoma formalisht është i veshur sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 (1999). Paneli vazhdoi duke thënë se autoritetet e Kosovës ekskluzivisht fajësoheshin për vendimin ndaj të cilit ishte parashtruar ankesë dhe nuk kishte indikacion të ndonjë përfshirje konkrete të UNMIK-ut në miratimin e këtij pozicioni, dhe as nuk ekzistonin rrethana të veçanta që do të justifikonin shmangien nga parimet e parashtruara më herët në vendim lidhur me përgjegjësinë e vazhdueshme të UNMIK-ut. Shih PKDNJ, *Kolë Krasniqi*, lënda nr. 48/08 (vendim i 13 marsit 2010).

51. Ngjashëm, në rastin *Thaçi*, Paneli theksoi se disa shkelje të të drejtave të njeriut për të cilat pohohej se ishin bërë në vitin 2009 nuk përfshinin përgjegjësinë e UNMIK-ut dhe prandaj pohimet e tilla ishin jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit. Këto pohime ishin pjesë e një ankese më të gjerë të paraqitur pranë Panelit, dhe Paneli miratoi një vendim

të pjesshëm për pranueshmërinë për t'i ndarë këto ankesa nga pjesa tjetër e ankesës që ishte nën juridiksionin *ratione personae* të Panelit, dhe ajo iu komunikua PSSP-së për të marrë përgjigje për pranueshmërinë. Shih PKDNJ, *Gani Thaçi*, lënda nr. 13/08 (vendim i pjesshëm i 9 shtatorit 2010).

52. Rasti *Gashi* ngriti një aspekt tjetër të kompetencës *ratione personae* të Panelit. Ankesa në fjalë pohonte parregullsi në procedurat e rekrutimit të EULEX-it, që funksionon në kuadër të autoritetit të përgjithshëm të UNMIK-ut me qasjen e tij neutrale për statusin e Kosovës. Mirëpo, vet kontesti nuk kishte të bënte me ndonjë çështje për të cilën UNMIK-u bartte përgjegjësinë përfundimtare sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Përkundrazi, kishte të bënte me parimet e brendshme të EULEX-it dhe me procedurën e sektorit të punësimit të EULEX-it për punësimin e stafit të ri. Prandaj, ankesa ishte jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit. Shih PKDNJ, *Lulzim Gashi*, lënda nr. 11/10 (vendim i 14 majit 2010).

### **Pranueshmëria Ratione Materiae**

53. Rasti *Rusinovci* ka të bëjë me një ankesë të paraqitur nga një pjesëtar i stafit të UNMIK-ut lidhur me përfundimin e kontratës së tij të punësimit për shkak të reduktimit të UNMIK-ut. PSSP-ja theksoi se Paneli ishte organ këshillëdhënës i themeluar të merret me trajtimin e shkeljeve të pohuara të të drejtave të njeriut që i atribuoheshin UNMIK-ut në rolin e tij si administratë e përkohshme në Kosovë dhe jo me ankesa që kanë të bëjnë me kontestet e brendshme të punësimit dhe çështjeve kontraktuese brenda UNMIK-ut. Paneli theksoi se në nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 thuhet se Paneli “shqyrton ankesat nga cilido person apo grup i personave të cilët pohojnë se janë viktime të shkeljeve të të drejtave të njeriut të bëra nga UNMIK-u” ashtu siç është përcaktuar në disa instrumente ndërkombëtare të shënuara në Rregullore. Paneli nuk gjeti ndonjë dallim të qartë në rregulloret ku përcaktohet kompetenca e Panelit që do ta ndryshonte kompetencën lëndore të Panelit nga pikëpamja e rolit të UNMIK-ut si administratë e përkohshme ose si punëdhënës apo palë në kontratë. Prandaj, UNMIK-u detyrohet të respektojë parimet edhe si administratë e përkohshme edhe si punëdhënës apo palë në kontratë. Prandaj, Paneli nuk e pranoi këtë kundërshtim të ngritur nga PSSP-ja, por ankesa u konstatua se ishte e papranueshme për arsye të tjera. Shih PKDNJ, *Hashim Rusinovci*, lënda nr. 43/10 (vendim i 18 qershorit 2010).

54. Në rastin *Đokić*, ankesa kishte të bënte me një kontest ligjor privat në mes të individëve dhe nuk përfshinte veprime apo mosveprime për të cilat fajësohej UNMIK-u. Ankuesi nuk ka mundur të jetë viktimë e shkeljeve të të drejtave të njeriut që janë kryer apo që i atribuohen UNMIK-ut. Prandaj, ankesa ishte jashtë juridiksionit *ratione materiae* të Panelit dhe u shpall e papranueshme. Shih PKDNJ, *Jagodinka Đokić*, lënda nr. 208/09 (vendim i 16 dhjetorit 2010).

55. Për rastin e vendosur në vitin 2009 (PKDNJ, *Ramadan Demirović*, lënda nr. 57/08), në *Kadri Balaj dhe të tjerët, rasti i II-të*, Paneli konfirmoi se është në diskrecionin e PSSP-së për të përcaktuar skemën rregullative të sistemit të ankesave të paraqitura pranë Panelit, dhe se Paneli nuk ka juridiksion të shqyrtojë përputhshmërinë e bazës ligjore për funksionimin e tij me standardet e të drejtave të njeriut. Përderisa Paneli theksoi se seriozisht mund të vihet në dyshim nëse PSSP-ja ka kompetenca të ndryshojë disa nga parimet bazë të përfshira në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12 përmes “implementimit” të një urdhërese administrative, për qëllimet e juridiksionit të Panelit, ai nuk bëri dallim nëse ndryshimet u bënë me rregullore apo me urdhëresë administrative. Qëndron fakti se dispozitat e Urdhëresës

administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 formojnë një pjesë të bazës së funksionimit të Panelit. Shih *Kadri Balaj dhe të tjerët. II* 320/09 (vendim i 12 shkurtit 2010).

### **Shterimi i mjeteve në dispozicion – Çështjet penale**

56. Kur hetimi penal për zhdukjen e një personi apo për rastin e një vrasjeje ka vazhduar me vite të tëra, argumenti se ankuesi duhet të shterojë mjetet sepse hetimi ende po vazhdon refuzohet nga Paneli. Shih PKDNJ, *D.P.*, lënda nr. 04/09 (vendim i 6 gushtit 2010).

57. Në raste të caktuara, PSSP-ja argumenton se ankesa është e papranueshme për shkak të mos-shterimit të mjeteve meqë rasti është në pritje për shqyrtim nga ndonjë prokuror i EULEX-it, por pranon se çështja e shterimit është ngushtë e lidhur me bazueshmërinë. Në rastet e tilla, Paneli e lidh çështjen me bazueshmërinë sipas Rregullës 31*bis* të Rregullores së punës në vend se të refuzojë argumentin e pranueshmërisë së PSSP-së. Shih PKDNJ, *R.P.*, lëndët me nr. 120/09 dhe 121/09 (vendim i 26 nëntorit 2010).

### **Shterimi i mjeteve në dispozicion – Çështjet civile**

58. Kur PSSP-ja paraqet kundërshtimin e tij duke u bazuar në mos-shterimin e mjeteve, ato mjete duhet identifikuar dhe ata duhet të trajtojnë objektin e ankesës. Në rastin *Morina*, PSSP-ja argumentoi se marrja e pronës private të ankuesit ndodhi për shkak të akteve të ndërmarra nga administratori ndërkombëtar i UNMIK-ut në një komunë jashtë kompetencave të tij (*ultra vires*) dhe se ankuesi duhet të shfrytëzojë procedurat administrative në dispozicion pranë komunës. Mirëpo, objekti i ankesës ishte konfiskimi i mallrave komerciale nga ankuesi përmes procedurës kriminale, dhe jo revokimi i licencës së tij nga administratori ndërkombëtar. Për më tepër, edhe pse është kërkuar të sqarohet baza ligjore mbi të cilën UNMIK-u pohoi se ka pasur mjete në dispozicion pranë komunës, UNMIK-u nuk e bëri këtë, dhe mjetet e tilla, në shikim të parë, nuk dukej se ekzistonin. Prandaj, Paneli vendosi të shqyrtojë çështjen e mjeteve në dispozicion nga aspekti i bazueshmërisë sipas nenit 13 të KEDNJ dhe ankesën e shpalli të pranueshme. Shih PKDNJ, *Jajha Morina*, lënda nr. 36/08 (vendim i 16 dhjetorit 2010).

59. Mirëpo, ankuesi akoma duhet të shterojë mjetet e njohura apo ato që qartazi janë në dispozicion para se ankesën ta paraqesë pranë Panelit. Në rastin *Jevtić*, ankuesi kishte paraqitur ankesë tanimë kundër një aktgjykimi të gjykatës që trajtonte çështjet e njëjta sikurse objekti i ankesës së tij të paraqitur pranë Panelit. Procedura e apelit ishte në pritje në kohën e marrjes së vendimit nga Paneli dhe nuk kishte pretendime se apeli ishte joefektiv dhe as se kishte apo se nevojitej shumë kohë për ta kompletuar. Në ato rrethana, Paneli konstatoi se ankesa ishte e nxituar dhe atë e shpalli të papranueshme për shkak të mos-shterimi të mjeteve. Shih PKDNJ, *Momir Jevtić*, lënda nr. 07/08 (vendim i 14 majit 2010).

60. Përveç mjeteve gjyqësore, duhet shterur edhe mjetet jogjyqësore në rrethana të caktuara. Në rastin *Rusinovci*, një pjesëtar i stafit të UNMIK-ut u ankua për drejtësinë e shkëputjes së kontratës së punës për shkak të reduktimit të UNMIK-ut. Paneli konstatoi se ankuesi së pari duhej shterur mjetet në dispozicion, meqë sistemi formal i Kombeve të Bashkuara për “Administrimin e Drejtësisë”, i paraqitur në Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme A/RES/63/253 të datës 24 dhjetor 2008, i është vënë në dispozicion ankuesit dhe ai duhej të kërkonte ndihmë përmes këtij sistemi. Edhe pse PSSP-ja argumentoi se edhe procedura joformale e negociatave dhe e ndërmjetësimit ishin në dispozicion të ankuesit, Paneli nuk mori vendim nëse procedurat e tilla formale të negociimit dhe ndërmjetësimit do të konsideroheshin mjete për t’u shterur, meqë sistemi formal i Kombeve të Bashkuara për

“Administrimin e Drejtësisë” përbënte një mjet i cili duhej shterur. Shih PKDNJ, *Hashim Rusinovci*, lënda nr. 43/10 (vendim i 18 qershorit 2010).

### **Shterimi i mjeteve në dispozicion – Procesi i Kombeve të Bashkuara për ankesa nga pala e tretë**

61. Pas miratimit të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1, Paneli konkludoi se ishte zhveshur nga kompetencat për të vendosur nëse Procesi i Kombeve të Bashkuara për ankesa nga pala e tretë, që vlente për UNMIK-un sipas nenit 7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47, ishte një mjet në dispozicion që duhej shterur dhe/ose që është i efektshëm në kuptim të nenit 13 të KEDNJ. Neni 2.2 i Urdhëresës administrative nr. 2009/1 parasheh që çdo ankesë “e cila është apo mund të bëhet në të ardhmen” subjekt i Procesit të Kombeve të Bashkuara për ankesa nga pala e tretë, që vlen për UNMIK-un sipas nenit 7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47, “do të konsiderohet e papranueshme”, për arsye se ky proces duhet të konsiderohet një mjet në dispozicion në kuptim të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, ankuesit është dashur t’i ofrohet ndihma e rëndomtë përmes mjeteve të cilat janë në dispozicion dhe janë të mjaftueshme për të bërë kompensimin për shkeljet e pohuara. Në rastet e mëparshme Paneli ka konstatuar se ekzistimi i mjeteve në fjalë duhet të jetë mjaft i sigurt jo vetëm në teori por edhe në praktikë, dhe në rastet kur këto mjete nuk janë të sigurta do të mungojë qasja dhe efektiviteti i nevojshëm. Zakonisht, Paneli vendos nëse mjete në dispozicion ka qenë efektiv në aspektin teorik dhe në praktikë. Mirëpo, Urdhëresa administrative e UNMIK-ut nr. 2009/1 e zhveshi Panelin nga kjo kompetencë duke e obliguar atë të merr parasysh Procesin e KB-së për ankesa nga pala e tretë si mjet të qasshëm dhe të efektshëm. Derisa Paneli pranoi se më nuk kishte kompetencë të vendosë nëse Procesi i KB-së për ankesa nga pala e tretë ishte mjet i efektshëm dhe i qasshëm, gjithashtu theksoi se paraqitja thjeshtë e një kundërshtimi bazuar në nenin 2.2 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 nuk shpie pashmangshëm tek konkludimi se ankesa konsiderohet e papranueshme. Paneli konsideroi se, kur paraqitet kundërshtim i tillë, duhet të sigurohet nëse objekti i ankesës së paraqitur pranë Panelit është i natyrës së tillë që me arsye mund të paraqesë ankesë që mund të trajtohet përmes Procesit të KB-së për ankesa nga pala e tretë. Paneli e shpall një ankesë të papranueshme vetëm kur sigurohet se ankesa është e tillë që në shikim të parë përfshihet brenda kufijve të Procesit të KB-së për ankesa nga pala e tretë. Për dallim nga kjo, e ka të pamundur të shqyrtojë nëse rezultati i procesit ka mundësi të ofrojë kompensim të mjaftueshëm lidhur me ankesën e paraqitur pranë Panelit, ose nëse procesi u ofron perspektivë të arsyeshme të suksesit ankuesve. Ankesat për shkeljen e të drejtave të njeriut që i atribuohen UNMIK-ut do të konsiderohen të papranueshme sipas nenit 2.2 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 nëse ata kanë rezultuar qoftë me lëndim personal, me sëmundje apo vdekje, ose me humbje të pronës ose me dëmtim. Ankesat për shkeljen e të drejtave të njeriut të cilat nuk kanë rezultuar me dëmtime të natyrës së tillë natyrisht se nuk do të jenë kundër kërkesës për shterimin e mjeteve me Procesin e KB-së për ankesa nga pala e tretë. Shih PKDNJ, *Kadri Balaj dhe të tjerët. I*, lënda nr. 04/07 (vendim i dytë i 31 marsit 2010) dhe PKDNJ, *N.M. dhe të tjerët*, lënda nr. 26/08 (vendim i dytë i 31 marsit 2010).

62. Në rastin *Kadri Balaj dhe të tjerët. I*, ankesa kishte të bënte me vrasjen dhe/ose plagosjen e rëndë të katër individëve të cilët morën pjesë në demonstratë, efektiviteti i hetimeve penale që pasuan, dhe pamundësia e ankuesve që të parashtronë ankesë kundër UNMIK-ut pranë cilësdo gjykate ose organi që do të ishte në gjendje të ofronte kompensim. Meqë ankesat kryesisht lidheshin me përdorimin e forcës nga Policia e UNMIK-ut, Paneli konstatoi se ata pjesë të ankesës, në shikim të parë, ishin në kuadër të kompetencave të

Procesit të KB-së për ankesa nga pala e tretë. Aspektet tjera procedurale të së drejtës për jetë dhe të drejtës për të mos iu nënshtruar torturës, si dhe shkeljet e së drejtës për gjykim të drejtë dhe për mjet të efektshëm juridik, kanë të bëjnë me veprime, me mosveprime ose situata që qartazi nuk rezultuan me lëndim personale, me sëmundje apo vdekje, as me humbje të pronës apo me dëmtime. Prandaj, Paneli konstatoi se ato ankesa nuk mbuloreshin nga Procesi i KB-së për ankesa nga palët e treta. Mirëpo, Paneli konstatoi se ankesat materiale dhe procedurale ishin aq të ndërlidhura, ashtu që do të ishte jo e natyrshme që ato të ndahen. Prandaj Paneli e shpalli tërë ankesën të papranueshme. Shih PKDNJ, *Kadri Balaj dhe të tjerët. I*, lënda nr. 04/07 (vendim i dytë i 31 marsit 2010).

63. Ngjashëm, në *N.M. dhe të tjerët*, ankesa ishte paraqitur nga 143 pjesëtarë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas në Kosovë (të cilit i referohemi si vendimi i romëve”) të cilët janë apo kanë qenë banorë në pesë kampe të administruara nga UNMIK-u për persona të zhvendosur brenda vendit (PZHBV) në veri të Mitrovicës. Të gjithë ankuesit ankohen se kanë pësuar nga helmimi me plumb dhe se kanë probleme të tjera shëndetësore për shkak të tokës së kontaminuar në hapësirat e kampit që ndodhet në afërsi të kompleksit të minierës dhe shkretesës së Trepçës, dhe/ose për shkak të higjienës përgjithësisht të dobët dhe standardit të jetesës në kampet. Ankesat materiale të shpallura të pranueshme nga Paneli në vendimin e tij të datës 5 qershor 2009 mbi pranueshmërinë, ishin drejtpërsëdrejti të lidhura me zgjidhjen fillestare operacionale për t’i vendosur PZHBV në kampet në fjalë dhe/ose me dështimin për t’i rivendosur ata, dhe me efektet e mëvonshme që rezultuan me lëndime personale, me sëmundje apo me vdekje. Paneli konsideroi se këto pjesë të ankesës, në shikim të parë, ishin brenda kufijve të Procesit të KB-së për ankesa nga pala e tretë dhe prandaj ishin konsideruar të papranueshme. Mirëpo, ankesat procedurale të shpallura të pranueshme nga Paneli, siç janë ankesat për shkeljen e aspekteve procedurale të së drejtës për jetë dhe ndalimi i trajtimit jonjerëzor apo degradues, si dhe për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe e drejta për mjet të efektshëm, kanë të bëjnë me veprime, me mosveprime ose situata që qartazi nuk kanë rezultuar me lëndim personal, me sëmundje ose me vdekje, as me humbje të pronës ose me dëmtime. Prandaj, Paneli konsideroi se këto pjesë të ankesës nuk mbuloreshin nga Procesi i KB-së për ankesa nga pala e tretë. Por Paneli vazhdoi të theksojë se ankesat materiale dhe procedurale që ishin në pritje për t’u trajtuar nga Paneli ishin aq të ndërlidhura ashtu që do të ishte e panatyrshme që ato të ndahen, duke rezultuar në trajtimin e ankesave materiale nga Procesi i KB-së për ankesa nga pala e tretë dhe ankesat procedurale, në të njëjtën kohë, nga Paneli. Prandaj, Paneli e shpalli tërë ankesën të papranueshme. Shih PKDNJ, *N.M. dhe të tjerët*, lënda nr. 26/08 (vendim i dytë i 31 marsit 2010).

64. Mirëpo, në të dy vendimet, Paneli theksoi se kërkesat për shterimin e mjeteve nga natyra e tyre janë kufizime të përkohshme të pranueshmërisë. Prandaj, efekti i shpalljes së papranueshmërisë për shkak të mos-shterimit të mjeteve në dispozicion, në parim është i vonuar dhe nuk ka efektin e formës së prerë. Kështu që, ankuesit do të ishin të lirë të parashtronjë sërish kërkesat e tyre pranë Panelit pasi të përfundohej procesi. PSSP-ja u pajtua me këtë konkludim dhe argumentoi se ankuesi do të kishte mundësi të paraqesë ankesë të re pasi të përfundohej procedura e ankesave të KB-së nga pala e tretë, dhe “deri më 31 mars 2010, dita e fundit për parashtrimin e ankesave pranë (Panelit)” sipas nenit 5 të Urdhresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1. Mirëpo, sipas këtij interpretimi, ankuesit gati gjithmonë do të ishin në kundërshtim me afatin e 31 marsit 2010 për paraqitjen e ankesave meqë Paneli po diskutonte për pranueshmërinë e rastit *Kadri Balaj dhe të tjerët. I* dhe *N.M. dhe të tjerët* në mars 2010. Paneli konstatoi se të detyrosh ankuesit të riparashtronjë ankesat e tyre, që kishin elemente që përndryshe ishin konstatuar se janë të pranueshme nga Paneli në vendimin e tij për pranueshmëri të datës qershor 2008, përkatësisht qershor 2009, para skadimit të afatit të fundit që sigurisht se do të kalonte para se të kompletohej procedura

tjetër, do të ishte ofendim për nocionet bazë të drejtësisë. Prandaj, bazuar në Rregullën 49 të Rregullores së punës të Panelit, e cila parasheh që çështjet që nuk janë mbuluar me Rregulloren e punës së Panelit të vendosen nga Paneli, Paneli vendosi që pas përfundimit të Procedurës së KB-së për ankesa nga pala e tretë, ankuesit mund të kërkojnë nga Paneli të rihapë procedurën dhe Paneli atëherë do të vendoste nëse do ta pranonte kërkesën e tillë. Shih PKDNJ, *Kadri Balaj dhe të tjerët. I*, lënda nr. 04/07 (vendim i dytë i 31 marsit 2010) dhe PKDNJ, *N.M. dhe të tjerët*, lënda nr. 26/08 (vendim i dytë i 31 marsit 2010).

### **Rishqyrtim i pranueshmërisë**

65. Pas miratimit të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1, Paneli do të rishqyrtojë çështjet e pranueshmërisë që dalin pasi të ketë marrë vendim për pranueshmërinë. Në rastet kur PSSP-ja tanimë ka ofruar komentet e UNMIK-ut për bazueshmërinë e ankesës, Paneli do të ndjekë Rregullën 33 § 2 të Rregullores së vet të punës, dhe vendimin e tij për pranueshmërinë do ta përfshij në mendimin e tij për bazueshmërinë, kurse në raste të tjera ku bazueshmëria nuk është diskutuar në tërësi, çështjen e pranueshmërisë do ta shpallë përmes një vendimi të dytë për pranueshmërinë. Në rastin *Kušić* për shembull, ankuesja u ankua për mosekzekutimin e vendimit nga Komisioni i Ankesave për Çështje Banësore Pronësore (HPCC) në favor të saj, si dhe për drejtësinë e procedurës dhe vet vendimin e HPCC. Ankesa ishte shpallur e pranueshme në tërësi me vendimin e Panelit të vitit 2008 dhe PSSP-ja tanimë i kishte ofruar komentet e tij për bazueshmërinë e ankesës. Mirëpo, duke pasur parasysh sigurimin e shkresave shtesë të lëndës lidhur me ankesën, Paneli konstatoi se ishin ngritur çështje shtesë të pranueshmërisë ashtu që u bë e qartë se ankuesja e kishte pranuar vendimin e formës së prerë të HPCC para më shumë se gjashtë muaj para se ajo e paraqiti ankesën e saj pranë Panelit. Në rrethana të tilla, Paneli ngrii çështjet e pranueshmërisë vullnetarisht dhe ato i trajtoi në kuadër të mendimit të tij. Paneli konstatoi se derisa vendimi i HPCC nuk ishte ekzekutuar dhe situata ende vazhdonte kur ankuesja e parashtroi ankesën e saj pranë Panelit, ankuesja në fakt kishte parashtuar ankesën e saj pranë Panelit më shumë se gjashtë muaj pasi ajo e kishte marrë vendimin e formës së prerë të HPCC. Kështu, Paneli i shpalli të gjitha ato ankesa që synonin drejtësinë e procedurës, dhe kështu edhe vetë esencën e vendimit të HPCC, të papranueshme si të jashtafatshme. Pjesa tjetër e ankesës lidhur me mosekzekutimin e vendimit nuk ishte në kundërshtim me rregullën gjashtëmujore dhe u shpall e pranueshme. Paneli pastaj vazhdoi me shqyrtimin e bazueshmërisë. Shih PKDNJ, *Nadica Kušić*, lënda nr. 08/07 (vendim i 15 majit 2010).

66. Në rastet kur bazueshmëria e ankesës nuk është diskutuar në tërësi nga palët, Paneli nxjerr një vendim të dytë për pranueshmërinë në pajtim me Urdhëresën administrative të UNMIK-ut 2009/1. Shih PKDNJ, *Kadri Balaj dhe të tjerët. I*, lënda nr. 04/07 (vendim i dytë i 31 marsit 2010) dhe PKDNJ, *N.M. dhe të tjerët*, lënda nr. 26/08 (vendim i dytë i 31 marsit 2010).

67. Mirëpo, në disa raste kur PSSP-ja ka diskutuar në tërësi bazueshmërinë e ankesës, nëse çështja e pranueshmërisë që paraqitet më vonë e bën ankesën në tërësi të papranueshme, Paneli nuk do të vazhdojë të procedojë me ankesën përmes një mendimi për bazueshmërinë që përfshin vendimin për çështjen e pranueshmërisë, por me një vendim të dytë për pranueshmërinë. Në rastin *Vasić* për shembull, ankuesi u ankua për mospërfshirjen në listë të punëtorëve të cilët kanë të drejtë në një pjesë të përfitimeve nga privatizimi i ndërmarrjes ku ai punonte më herët. Ai tanimë kishte paraqitur ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, e cila ishte refuzuar. Ankesa ishte shpallur e pranueshme nga Paneli në vitin 2008. Pasi që ankesa u shpall e pranueshme, PSSP-ja ofroi komente për pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e

ankesës, dhe më vonë e sugjeroi Panelin të kontaktojë Dhomën e Posaçme drejtpërsëdrejti, në vend se këtë ta bëjë përmes PSSP-së. Pas rishikimit të dosjeve të ruajtura nga Dhoma e Posaçme, Paneli mori “fletëpranimin” me të cilin dëshmohej se përfaqësuesi i autorizuar i ankuesit e kishte pranuar vendimin e formës së prerë në korrik 2006. Paneli konstatoi se dorëzimi i vendimit përfaqësuesit të autorizuar ishte njëjtë sikurse dorëzimi i vendimit vet ankuesit për qëllimet e rregullës gjashtëmujore, kështu që ankesa është parashtruar më shumë se gjashtë muaj pas vendimit të formës së prerë për këtë çështje. Prandaj, ankesa e parashtruar pranë Panelit është shpallur e papranueshme nga Paneli në tërësi përmes një vendimi të dytë për pranueshmërinë. Shih PKDNJ, *Ranko Vasić*, lënda nr. 02/07 (vendim i dytë i 6 gushtit 2010).

## 6.2. Heqja e lëndëve

68. Përveç rasteve ku ankuesit më nuk dëshironin të ndjekin ankesën (Shih p.sh. PKDNJ, *Gordana Bulatović*, lënda nr. 38/09 (vendim i 19 prillit 2010), Paneli po ashtu hoqi nga lista ato raste që ishin thjeshtë përsëritje e ankesave të paraqitura paraprakisht. Shih PKDNJ, *Slavi Mitić*, lënda nr. 102/09 (vendim i 19 prillit 2010), PKDNJ, *Snežana Milenković*, lënda nr. 313/09 (vendim i 19 prillit 2010), dhe PKDNJ, *Verica Patrnogić*, lënda nr. 334/09 (vendim i 9 shtatorit 2010).

## 6.3. Çështjet substanciale

### 6.3.1. Përgjegjësia e UNMIK-ut

69. Në rastin *Milogorić dhe të tjerët.*, ankuesit argumentuan se një shkresë e dërguar nga drejtori i Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut në vitin 2004, duke i urdhëruar gjykatat të mos procedojnë një kategori të caktuar të ankesave që ishin në pritje, duke përfshirë edhe ato të paraqitura nga ankuesit, ishte një ndërhyrje e drejtpërdrejtë në gjyqësor, që rezultoi me shkeljen e të drejtave të tyre për gjykim të shpejtë dhe qasje në gjykatë sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ. Duke pasur parasysh argumentet e ndryshme të palëve, Paneli e konsideroi relevante të shqyrtojë përgjegjësinë e UNMIK-ut në fushën e administrimit të drejtësisë, pasi kompetenca përkatëse ishte transferuar nga UNMIK-u tek Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në vitin 2004, pas ndërhyrjes nga UNMIK-u, që ishte thelbi i ankesave. Paneli ka theksuar që në fillim se në pajtim me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001, neni 1.5), gjykatat ishin në kuadër të IPVQ-ve. Mirëpo, gjithashtu përkujtoi se nga Korniza Kushtetuese, veçanërisht nga kapitulli 12, rezultoi se PSSP-ja kishte ruajtur kompetencat e mbikëqyrjes së IPVQ-ve, të zyrtarëve dhe agjencive të tyre. Ai veçanërisht ishte i autorizuar të ndërmarrë masa adekuate çdo herë kur veprimet e tyre nuk ishin në përputhje me Kornizën Kushtetuese. Meqë PSSP-ja duhej të “mbikëqyrte dhe të sigurote të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale” të pranuar ndërkombëtarisht, duke përfshirë edhe ato të drejta dhe liri të paraqitura në një sërë instrumentesh ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (neni 3.2), ishte kompetencë e PSSP-së të ndërmerre veprime nëse këto të drejta shkeleshin. Kjo e çoi Panelin te konkludimi se UNMIK-u ishte përgjegjës, nga perspektiva e të drejtave të njeriut, për çdo veprim apo mosveprim për të cilin fajësoheshin IPVQ-të. Kjo qasje pasoi pas qasjes së mëhershme të Panelit të paraqitur në rastin *Spahiu*, lënda nr. 02/08, në mendimin e tij të pjesshëm të 20 marsit 2009. Përfundimisht, dhe ajo çka është më e rëndësishmja për konkludimin e Panelit, në rastin *Milogorić dhe të tjerët*, ishte veprim i drejtpërdrejtë i UNMIK-ut, d.m.th. drejtori i Departamentit të Drejtësisë, dhe jo ndonjë veprim i IPVQ-ve, që

në fakt parandaloi gjykatat që të trajtojnë rastet e ankuesve. Shih PKDNJ, *Petko Milogorić dhe të tjerët*, lëndët me nr. 38/08, 58/08, 61/08, 63/08 dhe 69/08 (mendim i 24 marsit 2010).

### 6.3.2. Kompetenca kohore (*Ratione Temporis*)

70. Duke pasur parasysh rrethanat unike në të cilat funksionon Paneli, nuk është e nevojshme vetëm krijimi i një kornize për vlerësimin e situatave që janë në vazhdim e sipër të cilat filluan para 23 prillit 2005 (fillimi i juridiksionit kohor të Panelit sipas nenit 2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12), por edhe shqyrtimi se si duhet qasur situatave të cilat akoma vazhdonin kur UNMIK-u pushoi të ushtrojë kontroll efektiv në një fushë të caktuar pas shpalljes së njëanshme të pavarësisë nga autoritetet e Kosovës dhe reduktimit gradual të UNMIK-ut, duke pasur parasysh situatën politike gjatë vitit 2008 dhe 2009.

71. Paneli kishte mundësi të vlerësojë kompetencën e tij kohore (*ratione temporis*) në rastet e kohëzgjatjes së procedurës, kur procedura gjyqësore kishte filluar para 23 prillit 2005 në rastin *Emini*. Paneli konstatoi se periudha që duhet marrë në konsideratë për vlerësimin e kohëzgjatjes së procedurës fillon nga data e juridiksionit kohor të Panelit (23 prill 2005). Por, për vlerësimin e arsyeshmërisë së kohës që kaloi pas 23 prillit 2005, Paneli megjithatë do të merr parasysh gjendjen e procedurës në atë kohë. Rasti *Emini* përfshinte një kontest punësimi në mes të ankuesit dhe ish punëdhënësit të tij. Ankuesi kishte iniciuar procedurë civile në mbrojtje të të drejtave të tij civile më 17 prill 2003 që zgjati përafërsisht pesë vite, dhe përfundoi më 15 maj 2008 kur Gjykata Supreme e kaloi aktgjykimin e formës së prerë. Kështu që procedura zgjati pesë vite e njëzet e tetë ditë nga të cilat tri vite e njëzet e dy ditë duhej shqyrtuar nga Paneli në kuadër të kompetencave të tij kohore (*ratione temporis*). Shih PKDNJ, *Gani Emini*, lënda nr. 17/08 (mendim i 18 qershorit 2010).

72. Në rastet *Milogorić dhe të tjerët*, Paneli duhej të trajtojë një ngjarje që ndodhi para fillimit të juridiksionit kohor të Panelit, e që çoi në një situatë e cila zgjati deri në fund të kompetencave të UNMIK-ut në fushën përkatëse. Në rastet e tilla, që përbëjnë një pjesë të grupit të rasteve të njohura si “14,000 rastet”,<sup>23</sup> Paneli konstatoi se shkelja fillestare e pohuar nga aplikantët buronte nga shkresa e gushtit të vitit 2004 nga Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut, që ndaloi procedurën gjyqësore për një grup të caktuar të rasteve. Përderisa vetë shkresa nuk bënte pjesë në kuadër të juridiksionit kohor të Panelit meqë ajo ishte dërguar para 23 prillit 2005, efektet e saj u zgjeruan deri më 28 shtator 2008 kur u hoq ndalesa e procedurave. Kështu që ajo përbënte një situatë që vazhdonte deri në atë datë. Sikurse në rastin *Emini* më lart, Paneli mori në konsideratë periudhën nga fillimi i juridiksionit kohor të Panelit më 23 prill 2005, duke marrë po ashtu parasysh gjendjen e procedurës në atë datë. Për sa i përket përfundimit të kompetencës kohore (*ratione temporis*) të Panelit në rastet *Milogorić dhe të tjerët*, Paneli përkujtoi se më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me gjyqësorin në Kosovë përfundoi me marrjen e kontrollit të plotë operacional nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) në fushën e sundimit të së drejtës, dhe pas deklaratës së bërë nga Kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), duke përshëndetur angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë. Kështu, derisa ankuesit akoma ishin duke pritur lajmin për ndonjë progres për ankesat e tyre kur Paneli e miratoi mendimin e tij në mars 2010, Paneli megjithatë konkludoi se periudha që ishte nën shqyrtim për këtë lloj të ankesës kishte përfunduar më 9 dhjetor 2008, kur përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me gjyqësorin në Kosovë, dhe si pasojë edhe përgjegjësia e tij për trajtimin e këtyre rasteve

<sup>23</sup> Shih fusnotën 22 lart.



pushoi. Shih PKDNJ, *Petko Milogorić dhe të tjerët*, lëndët me nr. 38/08, 58/08, 61/08, 63/08 dhe 69/08 (mendim i 24 marsit 2010).

73. Në mënyrë të ngjashme, në rastin *Kušić*, Paneli theksoi se periudha nën konsiderim për shqyrtimin e një ankese kundër HPD dhe HPCC përfundoi pas skadimit të Rregullores përkatëse të UNMIK-ut me të cilin qeverisej funksionimi i organizatës pasardhëse të HPD-së, Agjencia Kosovare e Pronës, më 31 dhjetor 2008. Kjo për afërsisht coincidoi me vendosjen e EULEX-it si akter në fushën gjyqësore më 9 dhjetor 2008. Shih PKDNJ, *Nadica Kušić*, lënda nr. 08/07 (mendim i 15 majit 2010).

### **6.3.3. E drejta për jetë – neni 2 i KEDNJ**

74. Paneli theksoi se zhdukja e ndonjë personi në territorin e Kosovës në apo rreth kohës së konfliktit në Kosovë, ngriti supozimin e pakundërshtueshëm se personi u zhduk në rrethana kërcënuese për jetën, duke obliguar UNMIK-un të zbatojë hetime për zhdukjen e atij personi sipas nenit 2 të KEDNJ. Shih PKDNJ, *B.A.*, lënda nr. 52/09 (vendim i 21 tetorit 2010). Për shembull, në *B.A.*, babai 80 vjeçar i ankuesit ishte zhdukur menjëherë pa hyrjes së UNMIK-ut dhe KFOR-it në Kosovë në vitin 1999. Trupi i tij u zhvarros nga një varr i pashënuar në qershor të vitit 2000, dhe një autopsi që u bë më vonë tregoi se ai vdiq nga tronditjet e rënda në kokë. UNMIK-u argumentoi se për shkak të faktit se vdekja e viktimës u shkaktua nga një traumë e lehtë dhe se ai ishte 80 vjeçar në kohën kur u zhduk, ka gjasa që ai të jetë rrëzuar dhe kështu vdekja e tij të jetë shkaktuar aksidentalisht. Sipas UNMIK-ut, kjo situatë, e kombinuar me faktin se zhdukja e tij nuk ishte raportuar tek autoritetet në kohën kur ndodhi, çoi tek konkludimi se pak kishte bazë mbi të cilën UNMIK-u ka mundur të fillojë hetimet. Paneli refuzoi argumentin e UNMIK-ut.

75. UNMIK-u nuk mund të mbështetet në juridiksionin parësor të ICTY për ta liruar atë nga obligimi sipas nenit 2 të KEDNJ për zbatimin e një hetimi efektiv, së paku jo në mungesë të një komunikate formale nga ICTY duke kërkuar nga UNMIK-u t'u nënshtrohet kompetencave të veta në këtë çështje. Shih PKDNJ, *B.A.*, lënda nr. 52/09 (vendim i 21 tetorit 2010).

76. Duke iu përgjigjur ankesës ku pohohej se nuk ka pasur hetim efektiv për vrasjen e bashkëshortit dhe djalit të ankueses, UNMIK-u argumentoi se ICTY e kishte mandatin të hetojë të gjitha krimet për të cilat pohohej se ishin krime lufte në Kosovë dhe se ICTY i siguroi numër të kufizuar të dokumentacionit UNMIK-ut për këtë rast. Sipas UNMIK-ut, nuk ka pasur bazë mbi të cilën do të fillonte hetimet. Paneli refuzoi këto argumente, duke theksuar se nuk ka pasur kërkesë formale për shtyrje nga ICTY, që do të obligonte UNMIK-un të pezullojë hetimet e tij. Prandaj, pavarësisht nga interesimi fillestar i ICTY për këtë çështje, UNMIK-u akoma kishte përgjegjësi të hetojë vrasjet e dy personave sipas nenit 2 të KEDNJ. Shih PKDNJ, *S.C.*, lënda nr. 02/09 (vendim i 9 shtatorit 2010)

### **6.3.4. E drejta për gjykim të drejtë – neni 6 § 1 i KEDNJ**

#### **Zbatimi i nenit 6 § 1 të KEDNJ**

77. Në rastin *Vučković*, ankuesi argumentoi se Komisioni i Ankesave për Çështje Banësore Pronësore (HPCC), si organ për ankesa të shumta në përpjekje për të zgjidhur kontestet që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore banësore, shkeli të drejtën e tij për gjykim të drejtë për disa arsye. Kështu Paneli u përball me çështjen e zbatimit të nenit 6 § 1 të KEDNJ për HPCC dhe për procedurat e tij. Sa për informacion, pas ardhjes së UNMIK-ut në Kosovë, u

themelua Drejtoria për Çështje Banesore Pronësore (HPD) dhe HPCC me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/23 të 15 nëntorit 1999 për themelimin e Drejtorisë për Çështje Banesore Pronësore dhe Komisionit të Ankesave për Çështje Banesore Pronësore. Mandati i HPD ishte të rregullojë të drejtat pronësore banesore në Kosovë dhe të zgjidhë kontestet lidhur me pronën banesore. Qëllimi ishte të ofrojë udhëzime të përgjithshme për të drejtat pronësore në Kosovë në mënyrë që të arrihet zgjidhje efikase dhe efektive për ankesat që kanë të bëjnë me pronën banesore. Me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/23 u themelua HPCC si organ i pavarur i HPD përgjegjës për zgjidhjen e kontesteve jokomerciale lidhur me pronën banesore që i referoheshin atij nga HPD, derisa PSSP-ja vendosi se gjykatat vendore ishin në gjendje t'i kryejnë këto funksione. Gjatë analizimit të çështjes, Paneli përkujtoi se neni 6 § 1 i KEDNJ parimisht vlen vetëm për procedurat pranë një tribunali, që përcakton të drejtat civile dhe obligimet. Në këtë kontekst, Paneli theksoi se HPCC nuk ishte gjykatë klasike. Ishte organ për procedimin e ankesave të shumta i cili merrte vendime detyruese dhe të zbatueshme. Rregullorja e punës për procedurat pranë HPCC ishte paraqitur në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/60 të datës 31 tetor 2000 për ankesa të pronës banesore dhe Rregullorja e punës dhe dëshmitë e Drejtorisë për Çështje Banesore Pronësore dhe Komisionit të Ankesave për Çështje Banesore Pronësore, dhe HPCC vendosi për ankesat në një procesi adversarial në bazë të rregullave të drejtësisë. Këto vendime ishin të formës së prerë dhe u ekzekutuan nga një organ administrativ, i cili ishte HPD. Prandaj, HPCC ishte gjyqësor për nga funksioni dhe neni 6 i KEDNJ zbatohet për procedura pranë HPCC. Shih PKDNJ, *Milije Vučković*, lënda nr. 03/07 (mendim i 13 marsit 2010), PKDNJ, *Nadica Kušić*, lënda nr. 08/07 (mendim i 15 majit 2010), PKDNJ, *Simo Mitrović*, dhe lënda nr. 06/07 (mendim i 17 dhjetorit 2010), në mesin e rasteve të tjera.

### **E drejta për qasje në gjykatë**

78. Garancitë e paraqitura në nenin 6 § 1 të KEDNJ, e drejta për gjykim të drejtë, sigurojnë për të gjithë, mes tjerash, të drejtën për të paraqitur pranë një gjykate apo tribunali ankesë lidhur me të drejtat civile dhe obligimet; dhe në këtë mënyrë është mishëruar “e drejta për gjykatë”, nga e cila e drejta për qasje, d.m.th. e drejta për të iniciuar procedurë pranë gjykatave në çështjet civile, përbën një aspekt. Sa i përket kësaj çështjeje, Paneli ndoqi parimin e paraqitur nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përkujtoi se e drejta për qasje në gjykatë përfshinte jo vetëm të drejtën për të iniciuar procedurë por edhe të drejtën për të marrë një “vendim” të kontestit nga një gjykatë. Do të ishte zhgënjyese nëse një sistem ligjor do t'i lejonte individit të parashtrijë padi civile pranë një gjykate pa siguruar se rasti do të vendoset me vendim të formës së prerë në procedurë gjyqësore. Do të ishte e pakuptimtë për nenin 6 § 1 të përshkruaj në detaje garancitë procedurale që u ofrohen palëve ndërgjyqësore – procedura të cilat janë të drejta, publike, dhe të shpejta – pa u garantuar palëve se kontestet e tyre civile do të vendosen me vendim të formës së prerë. Sipas vlerësimit të Panelit, kjo e drejtë nuk është absolute, por mund t'u nënshtrohet kufizimeve; këto lejohen sipas situatës së nënkuptuar meqë e drejta për qasje nga vet natyra e saj kërkon rregullim nga autoritetet kompetente. Në këtë aspekt, autoritetet gëzojnë një rezervë të caktuar për të bërë vlerësimin. Mirëpo, kufizimet e zbatuara nuk duhet të kufizojnë apo reduktojnë qasjen që i është lejuar individit në atë mënyrë apo deri në atë shkallë ashtu që të dëmtohet vetë esenca e asaj të drejte. Për më tepër, kufizimi nuk do të ishte në përputhje me nenin 6 § 1 të KEDNJ nëse nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nëse nuk ka marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit në mes të mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet. Shih PKDNJ, *Petko Milogorić dhe të tjerët*, lëndët me nr. 38/08, 58/08, 61/08, 63/08 dhe 69/08 (mendim i 24 marsit 2010).

79. Në rastet *Milgorić dhe të tjerët*, ankuesit pohuan se shkresa e sipërpërmendur e gushtit të vitit 2004 nga Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut, që ndaloi procedurat gjyqësore për një grup të caktuar të lëndëve të shumta të paraqitura nga serbët e zhvendosur etnik për dëmet e shkaktuara pasurisë së tyre pas hyrjes së UNMIK-ut në Kosovë në vitin 1999, e që më vonë njiheshin si “14,000 rastet” (shih lart, §69), përbënte shkelje të aspekteve të ndryshme të nenit 6 § 1 të KEDNJ. Sa i përket qasjes në gjykatë, Paneli vërejti se ankuesit kishin gëzuar të drejtën e tyre për të ngritur procedurë ligjore për rastet e tyre në pajtim me ligjet përkatëse në fuqi. Ata e shfrytëzuan këtë mundësi duke paraqitur paditë e tyre me të cilat paditën autoritetet e ndryshme pranë gjykatave komunale apo atyre të qarkut për kompensim të pronës së tyre të dëmtuar që ndodhet në Kosovë. Mirëpo, rastet civile të ankuesve, në momentin kur u paraqitën paditë e tyre, u udhëzua që të ndalohen për shkak të kërkesës së Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut më 26 gusht 2004. Në përputhje me këtë, nuk ishte krijuar apo mbajtur asnjë procedurë pas paraqitjes së këtyre padive. Gjykatat përkatëse nuk morën asnjë vendim lidhur me ndalimin e procedurës për rastet e ankuesve. Lëndët tjera në këtë kategori të caktuar të rasteve u përballën me gjendjen e njëjtë pa rrugëdalje. Prandaj, Paneli konkludoi se e drejta e ankuesve për qasje në gjykatë ishte kufizuar për shkak të një iniciative të ndërmarrë drejtpërsëdrejti nga një organ i UNMIK-ut. Siç u tha më lart, kjo gjendje përfundoi më 28 shtator 2008, kur Departamenti i Drejtësisë ju bëri thirrje gjykatave të shqyrtojnë lëndët që i kishin pranë.

80. Pas konstatimit se e drejta për qasje në gjykatë ishte kufizuar, Paneli pastaj duhej të vendoste nëse UNMIK-u kishte vepruar në kuadër të kufijve të vlerësimit duke shqyrtuar nëse ishte dëmtuar vetë esenca e kësaj të drejte, dhe nëse jo, nëse masa e ndjekur ndiqte një qëllim legjitim dhe nëse ekzistonte një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit në mes të mjeteve të përdorura dhe objektivit të deklaruar. Gjatë vlerësimit të fakteve, Paneli vërejti se, të përballur me një valë të madhe të padive për kompensim brenda disa muajve, UNMIK-u zgjodhi që përkohësisht të parandalojë çfarëdo procedure për këto raste. Paneli konsideroi se, në fillim, përderisa qëllimi ishte të zgjaste për një periudhë shumë të kufizuar kohore, kjo masë do të dukej e arsyeshme, duke pasur parasysh rrjedhën e veprimeve të parashikuara të përcaktuara nga UNMIK-u në shkresën e gushtit të vitit 2004, d.m.th. ofrimi i ndihmës së nevojshme logjistike dhe krijimi i një baze të të dhënave për regjistrimin dhe evidentimin e progresit të këtyre ankesave nëpër gjykata.

81. Paneli u pajtua me argumentimin e UNMIK-ut se nevojitej planifikim dhe organizim i madh për t’u siguruar qasje në drejtësi atyre që UNMIK-u i pranonte si “paditës minoritar të cenusëshëm”. Paneli e konsideroi këtë si një qëllim legjitim për përfshirjen e UNMIK-ut në këtë çështje. Paneli përkujtoi se në një gjendje ku parashtrohen numër i madh i ankesave kundër një shteti për shuma të mëdha parash mund të ketë nevojë për rregullim të mëtejshëm nga shteti, dhe se në këtë aspekt shteti gëzon një rezervë të caktuar për të bërë vlerësimin e situatës. Mirëpo, masat e ndërmarra përsëri duhet të jenë në harmoni me nenin 6 § 1 të KEDNJ.

82. Pasi u konstatua se qëllimi ishte legjitim, Paneli pastaj duhej vazhduar për të vendosur nëse ka ekzistuar një marrëdhënie e arsyeshme në mes të mjeteve dhe qëllimit. Paneli konstatoi se kufizimi – në fakt mohimi i plotë i qasjes në gjykatë për individët të cilët kishin parashtruar këtë lloj të rasteve pranë gjykatës – zgjati katër vite. UNMIK-u argumentoi se fillimisht kishte shqyrtuar mundësinë e trajtimit të këtyre rasteve jashtë sistemit të gjykatave, por pastaj konsideroi se do të ishte më mirë që rastet e tilla të trajtohen nga gjykatat. Edhe pse UNMIK-u e pranoi nevojën për nxjerrjen e legjislacionit të ri dhe krijimin e kapaciteteve shtesë institucionale, në fakt nuk u miratua asnjë ligj i ri për rregullimin e kësaj çështjeje, dhe, për më tepër, nuk ishte e qartë se cilat hapa, nëse janë ndërmarrë, në fushën e krijimit të

kapaciteteve ishin relevante për këtë çështje, meqë nuk janë vërejtur përpjekje për riorganizim të sistemit nga UNMIK-u. Sipas vlerësimit të Panelit, duket se UNMIK-u kishte shpresuar për një kohë se numri i madh i ankesave do të zhdukej pas negociatave për statusin e Kosovës. Përderisa shpresa për një rezultat frytdhënës të negociatave politike përkatëse padyshim se ishte e arsyeshme së paku për një kohë, pas dështimit të kësaj marrëveshjeje, kjo çështje është dashur të ngrihet sërish si çështje urgjente. Thënë shkurt, për katër vite nuk është ndërmarrë asnjë veprim për zgjidhjen me sukses të kësaj çështjeje. Nuk ishte argumentuar as demonstruar se gjykatat ishin të gatshme të trajtojnë rastet deri në shtator 2008, për afërsisht dy muaj e gjysmë para bartjes së kompetencave të UNMIK-ut në fushën e drejtësisë tek EULEX-i, kur Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut i udhëzoi gjykatat të procedojnë me rastet të cilat ishin ndikuar me ndërhyrjen e bërë në gusht të vitit 2004, dhe ofroi çfarëdo mbështetje logjistike që mund të ishte e nevojshme.

83. Gjatë vlerësimit të të gjitha elementeve, Paneli konstatoi se UNMIK-u nuk kishte pasur sukses në arritjen e një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit në mes të mjeteve të përdorura dhe objektivit që kërkohej të arrihet. Katër vite të pasigurisë të cilët i përjetuan ankuesit rreth çështjes nëse dhe kur rastet e tyre do të procedoheshin nga gjykatat, u intensifikua gjatë kohës përkatëse nga fakti se shkresa e gushtit 2004 nuk kishte afat kohor për t'i mundësuar dikujt që me arsye të parashikojë se kur gjykatat do të fillonin procedimin e rasteve, nëse ndonjëherë do t'i procedonin. Siç u tha, nuk u miratua ndonjë ligj i ri në ndërkohë as nuk u siguruan mekanizma për të ndihmuar gjykatat që ankuesve t'u mundësojnë vendosjen e ankesave të tyre. Me pak fjalë, në vend se paditësve të cënueshëm minoritar t'u sigurohet qasje në drejtësi, Paneli konstatoi se UNMIK-u në fakt atyre ua mohoi këtë qasje duke shkelur nenin 6 § 1 të KEDNJ. Shih PKDNJ, *Petko Milogorić, dhe të tjerët*, lëndët me nr. 38/08, 58/08, 61/08, 63/08 dhe 69/08 (mendim i 24 marsit 2010).

### **Drejtësia e procedurës në përgjithësi**

84. Kur ankuesi pohon se procedura ka qenë e padrejtë dhe kjo ka çuar në një rezultat të padrejtë, Paneli vetëm konstaton shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë në nenin 6 § 1 të KEDNJ kur vendimi i tribunalit është aq goditës sa që procedura të mund të konsiderohet tepër arbitrare. Nuk është detyrë e Panelit të veprojë si gjykatë apeli mbi HPCC. Shih PKDNJ, *Milije Vučković*, lënda nr. 03/07 (mendim i 13 marsit 2010). Mirëpo, sa u përket fakteve në rastin *Vučković*, Paneli konstatoi se argumentet e ankuesit ishin të gabuara për sa u përket fakteve, ligjit ose të dyjave, e prandaj edhe u refuzuan.

### **Koha adekuate për përgatitjen e rastit**

85. Sa i përket njoftimit që pala duhet ta merr për të marrë pjesë në seancë dëgjimore apo për të dorëzuar dëshmi, e drejta për gjykim të drejtë nënkupton që njoftimi duhet të ofrojë një mundësi e cila është e mjaftueshme që pala t'ju përmbahet udhëzimeve të gjykatës apo tribunalit. Shih PKDNJ, *Radovan Parlić*, lënda nr. 01/07 (mendim i 18 qershorit 2010).

86. Në rastin *Parlić*, nga Paneli u kërkua të shqyrtojë nëse ankuesit i ishte ofruar kohë e arsyeshme të paraqitet pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, në ofertën e tij për t'u përfshirë në listën e punëtorëve të cikët kanë të drejtë në një pjesë të fitimeve nga privatizimi i një ish ndërmarrjeje në pronësi shoqërore. Në këtë rast, Dhoma e Posaçme e thirri ankuesin, i cili ndodhej në Serbi, në seancë dëgjimore në Kosovë me njoftim më të shkurtër se një javë. Në atë seancë dëgjimore, ankuesi ishte dashur të paraqiste librezën e tij të punës, një deklaratë për diskriminim, dhe dëshmi të tjera. Nga dosja në fakt nuk ishte e qartë se kur ankuesi e

kishte marrë thirrjen gjyqësore, dhe Paneli konsideroi se ai ka gjasa ta ketë marrë pas datës së seancës dëgjimore. Gjatë vlerësimit të arsyeshmërisë së njoftimit, Paneli së pari konsultoi legjislacionin ekzistues. Neni 34.1 i urdhëresës administrative 2003/13, ku parashihet procedura e zakonshme pranë Dhomës së Posaçme, parasheh që pala të njoftohet dy javë përpara seancës dëgjimore ku duhet paraqitur dëshmitë. Mirëpo, neni 64.1 i kësaj urdhërese administrative parashihet që neni 34 nuk ishte i zbatueshëm në procedurat që kanë të bëjnë me ankesa kundër listës së punëtorëve të cilët kanë të drejtë në një pjesë të fitimeve nga privatizimi. Prandaj, nuk është ofruar kohë minimale për njoftimin për seancën dëgjimore për procedurat siç është ajo e ankuesit. Kështu që, Paneli duhet të vendoste nëse njoftimi i ofroi ankuesit kohë të mjaftueshme për t’ju përgjigjur udhëzimit të Dhomës së Posaçme.

87. Për t’ju përgjigjur kërkesës së Dhomës së Posaçme për të paraqitur dëshmi të caktuara, ankuesi është dashur të bëjë përgatitjet e nevojshme për marrjen e librezës së punësimit. Ankuesi ishte person i zhvendosur i cili jetonte jashtë Kosovës, dhe nuk përfaqësohej nga avokat pranë Dhomës së Posaçme. Ai argumentoi se nuk ka pasur mundësi të kthehet në Kosovë për të marrë librezën e tij të punësimit personalisht, për shkak të pasigurisë dhe gjendjes së tij financiare. Sa i përket kësaj çështjeje, ai nuk u kundërshtua nga PSSP-ja edhe pse PSSP-ja tha se ankuesi ka mundur të kërkojë shtyrjen e seancës dëgjimore. Mirëpo, në urdhrin me të cilin kërkohej prania e ankuesit nuk përmendej një mundësi e tillë. Përkundrazi, aty në mënyrë eksplicite thuhej se seanca dëgjimore do të mbahej ashtu siç ishte caktuar, edhe nëse ankuesi nuk paraqitet. Për më tepër, derisa neni 34.2 i Urdhëresës administrative 2003/13 parashihet që cilado palë mund të kërkojë shtyrjen e seancës dëgjimore, dhe se kërkesa e tillë do të lejohej “nëse pala tregon se është e parandaluar të paraqitet në seancë dëgjimore për ndonjë arsye të rëndësishme”, neni 34 nuk ishte i zbatueshëm për procedurat lidhur me ankesat kundër listës së punëtorëve të cilët kanë të drejtë në një pjesë të fitimeve. Prandaj, mundësia që ankuesi të kërkonte shtyrjen nuk ishte opzion realist në atë kohë. Duke marrë parasysh të gjitha elementet, Paneli konstatoi se duke ditur situatën specifike të ankuesit, njoftimi prej një jave për t’u paraqitur pranë Dhomës së Posaçme dhe për të paraqitur dokumentacion përkatës, ishte tepër i shkurtër, meqë një afat i tillë kohor nuk i lejoi atij të përgatisë si duhet rastin e tij dhe prandaj ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ në këtë aspekt. Shih PKDNJ, *Radovan Parlić*, lënda nr. 01/07 (mendim i 18 qershorit 2010).

### **Vlerësim i dëshmime**

88. Sipas rregullës së përgjithshme, gjykatat kompetente duhet të vlerësojnë dëshmitë pranë tyre si dhe rëndësinë e dëshmimeve të cilën palët kërkojnë ta paraqesin. Paneli do të ndërhyjë vetëm kur vlerësimi i dëshmimeve ose konstatimi i fakteve nga gjykatat mund të vihet në dyshim nga arsyeja se në shikim të parë ata kanë qenë të paarsyeshëm apo në ndonjë mënyrë tjetër kanë qenë arbitrarisht. Paneli nuk zëvendëson vlerësimin e tij të fakteve me atë të gjykatës përkatëse apo të tribunalit. Detyra e Panelit është të sigurojë nëse procedura në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë vlerësuar dëshmitë, ka qenë e drejtë. Shih PKDNJ, *Radovan Parlić*, lënda nr. 01/07 (mendim i 18 qershorit 2010).

89. Në rastin *Parlić*, ankuesi kërkoi një pjesë të fitimeve nga privatizimi i ndërmarrjes. Pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, ai argumentoi se kishte qenë i punësuar nga një kompani që nga viti 1991 dhe se ai ishte larguar nga Kosova në qershor të vitit 1999. Ai tha se besonte se ishte diskriminuar nga fakti se emri i tij nuk ishte përfshirë në listën e publikuar të punëtorëve të cilët kishin të drejtë të marrin një pjesë të fitimit. Sa u përket dëshmimeve, ai tha se librezat e tij e punësimit kishte mbetur në ndërmarrje, dhe se lista e punëtorëve të kompanisë mund të gjendej në regjistrat e punëtorëve të kompanisë të mbajtur në njësinë e tij

punuese. Dhoma e Posaçme e ftoi ankuesin në seancë dëgjimore ku ai duhej të paraqiste librezën e tij të punësimit, një deklaratë për diskriminimin, dhe dëshmi të tjera. Ankuesi nuk u paraqit në seancë dëgjimore për arsyet e paraqitura në §§ 85-87 lart.

90. Lidhur me “deklaratën për diskriminim”, Dhoma e Posaçme e zbatoi nenin 8.1 të Ligjit kundër diskriminimit që barrën e dëshmisë lidhur me diskriminimin e zhvendos nga ankuesi tek i padituri dhe Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, pasi ankuesi tregoi “fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtë apo të tërthortë”. AKM-ja pastaj do të duhej të rrëzonte supozimin, duke dëshmuar se nuk ka pasur shkelje të parimit për trajtim të barabartë. Dhoma e Posaçme e refuzoi ankesën për arsye se ankuesi nuk mori pjesë në seancë dëgjimore dhe nuk paraqiti dëshmitë e kërkuara për të dëshmuar se ai ka punuar në kohën e privatizimit dhe nuk paraqiti “deklaratën për diskriminim” në seancën dëgjimore, d.m.th. nuk paraqiti fakte në bazë të të cilave do të supozohej se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

91. Në aktgjykimin e saj, Dhoma e Posaçme pranoi ankesat e një numri të ankuesve të tjerë, edhe pse ata po ashtu nuk kishin pasur mundësi të paraqesin librezat e tyre të punës. Në këto raste Dhoma e Posaçme pranoi se diskriminimi mund të rezultojë nga situata e krijuar “pas luftës dhe pamundësisë së aplikuesve që të kthehen në punë për shkak të shqetësimeve të tyre të sigurisë” dhe nga fakti “se emri i ankuesit nuk ishte përfshirë në listën e publikuar edhe pse ai i plotësonte kushtet ligjore për t’u përfshirë në listë”. Për sa i përket pjesës së Panelit ai konkludoi se arsyeja e vetme pse Dhoma e Posaçme e refuzoi ankesën e ankuesit ishte se ai nuk kishte paraqitur “deklaratë për diskriminim”.

92. Paneli vërejti se, edhe pse ankuesi e kishte bërë të qartë në ankesën e tij drejtuar Dhomës së Posaçme se ai besonte se kishte qenë viktimë e diskriminimit. Dhoma e Posaçme nuk duket se e ka marrë në konsideratë këtë deklaratë. Duket se Dhoma e Posaçme do ta kishte marrë këtë pohim parasysh vetëm nëse do të ishte konfirmuar formalisht në një “deklaratë për diskriminim” në një datë të mëvonshme. Për aq sa vendimi i Dhomës së Posaçme u interpretua ashtu që të nënkuptojë se “deklarata për diskriminim” do të mund të merrej parasysh vetëm nëse gojarisht do të mund të konfirmohej nga ankuesi gjatë seancës dëgjimore, Paneli e vlerësoi këtë së bashku me mosnjohimin adekuat për seancën dëgjimore (shih lart §§ 85-87) dhe konkludoi se Dhoma e Posaçme nuk i siguroi atij gjykim të drejtë, duke shkelur nenin 6 § 1 të KEDNJ. Shih PKDNJ, *Radovan Parlić*, lënda nr. 01/07 (mendim i 18 qershorit 2010).

### **Tribunali i pavarur dhe i paanshëm**

93. Paanshmëria, në kuptim të nenit 6 § 1 të KEDNJ, zakonisht nënkupton mungesën e paragjyimit apo anësisë. Ekzistojnë dy teste për të vlerësuar nëse një tribunal është i paanshëm: i pari konsiston në kërkimin për të konstatuar bindjen apo interesin personal të një vendimmarrësi të caktuar në një rast të caktuar, dhe i dyti në sigurimin nëse vendimmarrësi ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çfarëdo dyshimi legjitim në këtë aspekt.

94. Në rastin *Mitrović*, nga Paneli u kërkua të vendosë nëse Komisioni i Ankesave për çështje Banësore Pronësore ishte një tribunal i paanshëm nga fakti se Paneli i njëjtë i cili vendosi për çështjet në instancën e parë gjithashtu vendosi për kërkesën për rishqyrtim të rastit. Shih PKDNJ, *Simo Mitrović*, lënda nr. 06/07 (mendim i 17 dhjetorit 2010). Meqë ankuesi nuk vuri në dyshim anëtarët e HPCC, Paneli zbatoi një test objektiv, dhe shikoi nëse kishte fakte të verifikuara që mund të ngritin dyshime për sa i përket paanshmërisë së HPCC-së, nëse kishte arsye legjitime për t’u frikësuar se i mungonte paanshmëria, dhe nëse frika

mund të thuhet se ka qenë objektivisht e justifikueshme. Paneli po ashtu mori parasysh praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ku është theksuar se pjesëmarrja në procedurën e apelit e gjyqtarëve të cilët e kanë trajtuar rastin në procedurën e shkallës së parë mund të përbëjë shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ.

95. Paneli pranoi se një situatë ku paneli i njëjtë i HPCC vendosi edhe për kërkesën fillestare edhe për kërkesën për rishqyrtim të rastit mund të ngritë dyshime në mendjen e ankuesit për sa i përket paanshmërisë së panelit të HPCC. Paneli tutje vazhdoi të vlerësojë nëse ato dyshime objektivisht ishin të justifikueshme. Në këtë aspekt, duhej marrë parasysh natyrën e procedurës së rishqyrtimit. Paneli përkujtoi se neni 14.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60 i mundësonte çdo pale në ankesë të paraqesë kërkesë për rishqyrtim bazuar në “(a) pas paraqitjes së dëshmive përkatëse ligjore, që nuk janë shqyrtuar nga [HPCC] për vendosjen e ankesës, ose “(b) për arsyen se ka pasur gabim material në zbatimin e kësaj rregulloreje”. Përderisa arsyeja e parë dukej se e kufizonte mundësinë për të fituar rishqyrtimin për rrethanat specifike përjashtimore, arsyeja e dytë e kishte efektin që kërkesën për rishqyrtim ta bëjë të njëjtë me ankesën nga gjendja juridike dhe faktike.

96. Për më tepër, obligimi i HPCC që të shqyrtojë jo vetëm dëshmitë e reja por edhe dëshmitë që tanimë i janë dorëzuar gjatë procedurës fillestare, konfirmoi se një kërkesë për rishqyrtim nuk mund të konsiderohej si mjet i jashtëzakonshëm. Në këtë aspekt, Paneli u tërhoq nga mendimi që kishte shprehur në vendimin e tij të mëhershëm për pranueshmërinë për lëndën me numër 43/08, *Simić* (vendim i 12 dhjetorit 2008, § 14). Në rastin *Mitrović*, ankuesi argumentoi në kërkesën e tij për rishqyrtim se, në esencë, HPCC gabimisht kishte vlerësuar elementet e rastit. Sipas ankuesit, ai kishte ofruar dëshmi të mjaftueshme se ai kishte të drejta të caktuara për banesën të cilën e kërkonte dhe se kishte mënyra për të verifikuar se ai kishte jetuar në banesë para se të largohet nga Kosova. Paneli konstatoi se HPCC e mori vendimin për rishqyrtim pasi bëri një kontroll të freskët të dëshmive që tanimë i kishte në dispozicion dhe pas përpjekjeve të reja për të verifikuar dokumentet e dorëzuara dhe pohimet e bëra nga ankuesi. Konkludoi se nuk ishte bërë gabim dhe se nuk ishin paraqitur dëshmi të reja që do të kërkonin ndryshimin e vendimit të tij. Kështu që Paneli mësoi se HPCC në fakt ishte ftuar të shikojë sërish elementet e rastit, dhe se në fakt i kishte rishikuar ata. Nuk e kufizoi rishqyrtimin e tij vetëm në dëshmitë e paraqitura rishtazi.

97. Paneli përkujtoi se, sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kur gjyqtarët e njëjtë thirren për të vendosur nëse ata vetë kanë bërë “gabim në interpretimin apo zbatimin ligjor” apo jo në vendimin e tyre të mëhershëm, nga ata në fakt kërkohet të “gjykojnë veten e tyre dhe aftësinë e tyre në zbatimin e ligjit”. Një situatë e tillë është e mjaftueshme për të ekzistuar frika nga mungesa e paanshmërisë së gjykatës që duhet justifikuar objektivisht. Si rrjedhojë doli se HPCC nuk ishte e paanshme në kuptim të nenit 6 § 1 të KEDNJ kur duhej të shqyrtonte kërkesën për rishqyrtim. Shih PKDNJ, *Simo Mitrović*, lënda nr. 06/07 (mendim i 17 dhjetorit 2010).

#### **Vendim i arsyetuar**

98. Në pajtim me “një parim të lidhur me administrimin e duhur të drejtësisë, aktgjykimet e gjykatave dhe tribunaleve në mënyrë adekuate duhet t’i theksojnë arsyet në të cilat ata bazohen”. Mirëpo, “shkalla deri ku ky detyrim për të dhënë arsyet zbatohet mund të ndryshojë sipas llojit të vendimit dhe duhet të vendoset në frymën e rrethanave të rastit”. Shih PKDNJ, *Simo Mitrović*, lënda nr. 06/07 (mendim i 17 dhjetorit 2010).

99. Gjithashtu, në rastin *Mitrović*, ankuesi argumentoi se HPCC nuk ia dha besimin kontratës së shitblerjes të cilën ai e kishte paraqitur, pa e shpjeguar metodën e verifikimit që e

kishte përdorur për të ardhur tek ai konkludim. Paneli vërejti se, sikurse vendimi fillestar, vendimi për rishqyrtim në fakt nuk shpjegoi pse kontrata nuk mund të verifikohet. Kjo rrethanë ngriti dyshimin nëse ai vendim mund të thuhet se ishte i arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme. Paneli konstatoi se në procedurat ku në mënyrë specifike është paraparë të trajtohen numër i madh i ankesave, sikurse në ato të HPCC, detyrimi për të dhënë arsyet nuk mund të kuptohet në mënyrën e njëjtë ashtu siç duhet të kuptohet në procedurat e rregullta pranë gjykatave të rëndomta. Nuk është detyrë e Panelit të elaborojë një teori të përgjithshme për këtë çështje. Paneli u kufizua në atë që të tregojë se në procedurat ku shqyrtohen numër i madh i ankesave, sikurse ato në HPCC, mund të jetë e mjaftueshme, nga pikëvështrimi i drejtësisë së procedurës, se vendimi i tribunalit tregon në përgjithësi pse një ankesë pranohet apo refuzohet, pa ju referuar në mënyrë eksplicite elementeve konkrete të rastit të caktuar, me kusht që arsyetimi të gjejë mbështetje tek elementet e dosjes. Paneli duhet të verifikojë në fakt nëse përkrahja e tillë mund të gjendet. Në të vërtetë, bazuar në elementet e dosjes, të përshkruar në detaje në mendimin e Panelit, Paneli nuk mundi të gjejë indikacione të arbitraritetit për sa i përket metodës së verifikimit të përdorur nga HPCC. Shih PKDNJ, *Simo Mitrović*, lënda nr. 06/07 (mendim i 17 dhjetorit 2010).

100. Mirëpo, Paneli nuk do të merrte parasysh dëshmi të cilat nuk i janë siguruar organit vendimmarrës kur e ka marrë vendimin e tij për të vlerësuar nëse vendimi ishte mjaftueshëm i arsyetuar. Në rastin *Andjelković*, ankuesja i siguroi Panelit një dokument shtesë si dëshmi se ajo e kishte marrë pronën në fjalë në kohën përkatëse. Mirëpo, duket se dokumenti asnjëherë nuk i ishte paraqitur HPCC. Kështu që, pavarësisht se çfarë vlere dëshmuese ka ai dokument, Paneli theksoi se HPCC është dashur të shqyrtojë dokumentin dhe të marrë konkludime për vlerën e tij dëshmuese. Sa i përket pjesës së Panelit, ai nuk ka mundur të shqyrtojë vetëm vlerësimin e bërë nga HPCC dhe nuk ka mundur të vijë në konkludime bazuar në parashtrimin e dëshmisë që asnjëherë nuk i ishte dorëzuar organit vendimmarrja e të cilit ishte subjekt i ankesës së parashtruar pranë tij. Dështimi fillestar i ankuesit për t'i ofruar informacione të tilla HPCC nuk mund të korrigjohet në procedurat e ngritura pranë Panelit. Shih HRAP, *Vesna Andjelković*, lënda nr. 11/07 (mendim i 17 dhjetorit 2010).

### **Kohëzgjatja e procedurës – Procedura gjyqësore**

101. Sa i përket kohëzgjatjes së procedurës për çështjet civile, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet vlerësuar nga pikëpamja e rrethanave të rastit dhe duke iu referuar kriterëve vijuese: ndërlikueshmëria e rastit, sjellja e ankuesit dhe e autoriteteve relevante, dhe në çfarë aspekti është dëmtuar ankuesi në këtë kontest. Është detyrë e autoriteteve relevante të organizojnë sistemin e tyre ligjor ashtu që gjykatave t'u mundësojnë t'i përmbushin kushtet e nenit 6 § 1 të KEDNJ, duke përfshirë edhe kushtin për gjykim brenda “një kohe të arsyeshme”. Megjithatë, një grumbull i përkohshëm i punëve të gjykatës nuk nënkupton përgjegjësi të autoriteteve nëse ata ndërmarrin veprime të duhura riparuese me shpejtësinë e kërkuar. Shih PKDNJ, *Gani Emini*, lënda nr. 17/08 (mendim i 18 qershorit 2010) dhe PKDNJ, *Simo Mitrović*, 06/07 (mendim i 17 dhjetorit 2010).

102. Në rastin *Emini*, ankuesi ishte përfshirë në një kontest punësimi me ish punëdhënësin e tij dhe kishte iniciuar procedurë civile për të mbrojtur të drejtat e tij të punës në vitin 2003. Procedura zgjati përafërsisht pesë vite dhe ankuesi, mes tjerash, argumentoi se kohëzgjatja e procedurës ishte pa arsye shumë e gjatë duke shkelur nenin 6 § 1 të KEDNJ. Paneli vërejti se përafërsisht dy vite e gjysmë (nga të cilat rreth një vit e gjysmë pas 23 prillit 2005, shih lart, §§ 70-72) kishin kaluar duke e mbajtur dosjen në nivel të gjykatës së qarkut. Paneli e pranoi shpjegimin e gjykatës se vonesa ishte shkaktuar për shkak të grumbullit të madh të lëndëve dhe mungesës së gjyqtarëve të cilët merreshin me çështje civile në gjykatë. Paneli gjithashtu



pranoi vështirësitë me të cilat u përballën gjykatat në Kosovë për shkak të gjendjes së pas luftës. Në anën tjetër, Paneli vërejti se nuk ishin ndërmarrë veprime të duhura riparuese për trajtimin e situatës, qoftë nga UNMIK-u apo nga gjykatat, dhe si do që të ishte, nëse masat ishin ndërmarrë, ata nuk dukej se kishin pasur efekt gjatë periudhës përkatëse. Prandaj, duke shqyrtuar se në çfarë aspekti ishte rrezikuar ankuesi, nga aspekti i mënyrës së punësimit dhe kështu edhe mjeteve të jetesës, Paneli konstatoi se gjykata nuk tregoi kujdesin e veçantë të duhur që kërkohej nga ajo sipas ligjit në fuqi dhe sipas KEDNJ. Prandaj, Paneli konstatoi se kohëzgjatja e procedurës në këtë rast ishte jashtë mase e tepruar dhe nuk përmbushi kushtin për kohë të arsyeshme në nenin 6 të KEDNJ. Shih PKDNJ, *Gani Emini*, lënda nr. 17/08 (mendim i 18 qershorit 2010).

103. Në rastin *Mitrović*, procedura relevante pranë HPCC filloi më 21 mars 2002 dhe përfundoi më 9 maj 2007, kur ankuesi e mori vendimin për rishqyrtim. Mirëpo, periudha që duhej shqyrtuar filloi nga data e juridiksionit kohor të Panelit, që është 23 prill 2005. Kohëzgjatja e përgjithshme e procedurës pra ishte pesë vite e një muaj e tetëmbëdhjetë ditë, nga të cilat dy vite dhe gjashtëmbëdhjetë ditë duhej shqyrtuar nga Paneli. Në vlerësimin e fakteve, Paneli pranoi se rasti *Mitrović* paraqiste një ndërlikueshmëri të caktuar, por Paneli ishte i mendimit se çështjet në këtë rast në asnjë mënyrë nuk ishin të veçanta. Paneli po ashtu vërejti se ankuesi nuk i kontribuoi asnjë vonese në procedurë. Sa i përket sjelljes së autoriteteve, Paneli theksoi se ka pasur vonesa të konsiderueshme në procedurën fillestare, edhe pse pjesa më e madhe e asaj periudhe ishte jashtë juridiksionit të Panelit meqë kjo ishte para 23 prillit 2005. Mirëpo, pas kësaj periudhe të vonesës, procedura fillestare vazhdoi pa vonesa të mëdha dhe vendimi fillestar u miratua më 21 tetor 2005 dhe u certifikua më 5 dhjetor 2005. Ankuesi u njoftua për vendimin më 12 janar 2006 dhe vendimi iu dërgua atij më 16 mars 2006. Pas marrjes së kërkesës për rishqyrtim nga zyra e HPD në Beograd më 24 mars 2006, HPD kontaktoi fqinjët për të marrë deklaratat të dëshmitarëve, e njoftoi të paditurin për kërkesën, kontaktoi ankuesin me telefon për informacione të mëtejshme, dhe e dorëzoi raportin për procedimin e ankesave më 27 tetor 2006. HPCC e miratoi vendimin e tij më 11 dhjetor 2006, i cili u certifikua më 23 mars 2007 dhe iu dërgua ankuesit më 7 maj 2007. Mirëpo, ndryshe nga rasti *Emini*, Paneli mori parasysh shpejtësinë relative të procedurës gjatë periudhës sa rasti ishte duke u shqyrtuar nga ai dhe numrin e madh të rasteve të pranuar nga HPD për t'u gjykuar nga HPCC, si dhe vështirësitë logjistike me të cilat u përballën në kontekstin e Kosovës pas konfliktit, dhe konstatoi se, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit, koha e arsyeshme nuk kishte kaluar dhe nuk kishte shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ në këtë aspekt. Ishte po ashtu e rëndësishme se procedura u zhvillua pranë një tribunali ku trajtoheshin kërkesa në numër shumë të madh për dallim nga gjykatat e rregullta, dhe këtu përfshihej një kontest punësimi, për dallim nga ankesat që ishin në konkurrencë për pronë banesore. Shih PKDNJ, *Simo Mitrović*, 06/07 (mendim i 17 dhjetorit 2010).

### **Kohëzgjatja e procedurës – Ekzekutimi i vendimeve**

104. Ekzekutimi i një vendimi nga një tribunal është pjesë integrale e një gjykimi për qëllimet e nenit 6 të KEDNJ. Kështu që, një vonesë e gjatë e paarsyeshme në zbatimin e një aktgjykimi detyruet mund të jetë shkelje e KEDNJ, varësisht nga ndërlikueshmëria e procedurës së zbatimit, sjellja e ankuesit dhe e autoriteteve kompetente, dhe lartësia e natyra e vendimit në fjalë. Ndërlikueshmëria e procedurës së zbatimit nuk i liron autoritetet nga detyrimi i tyre sipas KEDNJ për t'i garantuar secilit të drejtën që vendimi i tyre detyruet dhe i zbatueshëm të ekzekutohet brenda një kohe të arsyeshme. Autoritetet relevante duhet të organizojnë sistemet e tyre ligjore ashtu që të sigurojnë ekzekutimin e aktgjykimeve brenda një kohe të arsyeshme. Si standard të përgjithshëm, Paneli ka miratuar qasjen e 'Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut' që vonesat më të gjata se një vit në ekzekutimin e një

vendimi janë në shikim të parë të paarsyeshme. Shih PKDNJ, *Nadica Kušić*, lënda nr. 08/07 (mendim i 15 majit 2010).

105. Në rastin *Kušić*, ankuesi kishte blerë një banesë në Kosovë kah mesi i viteve të 90-ta. Mirëpo, më herët, një personi tjetër ju kishte ndarë e njëjta banesë, por i cili më pas e kishte humbur vendin e punës si dhe banesën e cila ju kishte ndarë atij, me gjasë për shkak të diskriminimit. Pas konfliktit në Kosovë, dhe largimit të shumë individëve joshqiptarë nga Kosova, banori i parë e zuri sërish banesën e njëjtë. Ankuesi dhe banori i përparshëm që të dy paraqitën ankesa në HPCC. HPCC morri vendim duke konstatuar se të dy personat kishin të drejta valide për këtë banesë. HPCC e konfirmoi këtë konstatim në vendimin e tij për rishqyrtim të datës 31 mars 2006.

106. Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/60, HPCC i dha banorit të parë të drejtën ta zë banesën, me kusht që ai të paguante një shumë të hollash për të. Lartësia e asaj shume do të përcaktohej nga HPD. Pasi të njoftohej për shumën, do të kishte 120 ditë që këtë shumë t'ia paguaj HPD, dhe në këtë rast ankuesja pastaj do të kompensohej nga HPD për shumën që ajo ka paguar për blerjen e banesës, si dhe një përqindje të vlerës aktuale të tregut, si dhe për shpenzimet e riparimeve që ajo ka mundur t'i bëjë në banesë. Nëse banori i parë nuk do ta paguante shumën, ankuesja do të kishte mundësi ta marrë pronën. Mirëpo, sipas informacioneve të siguruara nga AKP në fund të vitit 2008, vendimi nuk ishte implementuar për shkak se normat për rregullimin e kompensimit akoma nuk ishin nxjerrë nga AKP. Sipas raportit vjetor 2009 të AKP, çështja e skemës së kompensimit ishte akoma duke u diskutuar në fund të vitit 2009.

107. Gjatë vlerësimit të elementeve më lart në rastin *Kušić*, Paneli konstatoi se në datën kur skadoi autoriteti i UNMIK-ut, vendimi i HPCC ishte akoma në pritje për t'u ekzekutuar për një vit dhe nëntë muaj. Në atë kohë, ankuesi nuk mund të parashihte se kur do të ekzekutohej vendimi. Sa i përket ndërlikueshmërisë së procedurës së ekzekutimit dhe sjelljes së ankuesit, Paneli konstatoi se nuk kishte procedura të ekzekutimit për të cilat duhej diskutuar, dhe se ankuesi nuk i kishte kontribuar vonesës së ekzekutimit. UNMIK-u u mbështet në situatën komplekse ligjore dhe politike në Kosovë për të mbrojtur vonesën rreth nxjerrjes së legjislacionit të nevojshëm për ekzekutimin e vendimit, përkundër faktit se legjislacioni në fjalë ishte i paraparë në rregulloret e UNMIK-ut në fillim të vitit 2000.

108. Paneli pranoi se autoritetet relevante gëzojnë diskrecion të gjerë dhe sidomos në kontekstin unik në të cilin vepron UNMIK-u. Mirëpo, formula për caktimin e shumës për kompensim akoma ishte në pritje për t'u miratuar pas nëntë vitesh.<sup>24</sup> Derisa hapa pozitivë filluan me mbajtjen e një konsulenti që të punojë për formulën e kompensimit në vitin 2004, UNMIK-u nuk kishte paraqitur argumente bindëse pse formula e nevojshme mbeti e paimplementuar katër vite më vonë në dhjetor të vitit 2008, kur pushoi të jetë përgjegjëse për funksionimin e AKP. Kështu që, ankuesi ishte i përballur me pasigurinë e një pritjeje të papërcaktuar.

109. Për më tepër, meqë pas caktimit të shumës që duhet paguar, banori i parë do të kishte mundësinë të zgjedhë në mes të pagimit të shumës (në të cilin rast do të kishte të drejtë të posedimit të banesës, kurse ankuesi do të merrte kompensimin) ose të mos e paguaj shumën (në të cilin rast nuk do të kishte të drejtën e posedimit të banesës, kurse ankuesi do të kishte të drejtë në posedim) Paneli konkludoi se vet natyra e vendimit nuk ishte e parëndësishme. Dallimi në mes të dy rezultateve të mundshme të këtij procesi do të ishte i rëndësishëm dhe

<sup>24</sup> Akoma është në pritje që nga publikimi i këtij raporti.

do të kishte ndikim të madh tek ankuesi. Kjo divergjencë në rezultatet e mundshme çoi Panelin tek konkludimi se natyra e vendimit ishte faktor i rëndësishëm që duhej marrë parasysh në rastin *Kušić*.

110. Duke pasur parasysh të gjitha elementet e cekura më lart, Paneli konkludoi se vonesa në ekzekutimin e vendimit të HPCC ishte tepër e gjatë dhe se kishte pasur shkelje të nenit 6 të KEDNJ. Shih PKDNJ, *Nadica Kušić*, lënda nr. 08/07 (mendim i 15 majit 2010).

### **6.3.5. E drejta për gëzim të papenguar të pronës**

111. Në rastin *Spahiu*, Paneli theksoi se në nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ, që përfshin të drejtën për gëzim të papenguar të pronës, që në fillim kërkohet që çdo ndërhyrje në pronën e tjetrit duhet të jetë e ligjshme. Në këtë rast, Paneli konstatoi se delegimi i kompetencave nga Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media tek zyrtari ekzekutiv i Komisionit të Pavarur për Media lidhur me autorizimin për urdhërimin e sanksioneve (në këtë rast konfiskimin), nuk ishte bërë në pajtim me ligjin në fuqi në atë kohë. Meqë delegimi i kompetencave ishte i paligjshëm, urdhri i mëvonshëm nga zyrtari ekzekutiv i Komisionit të Pavarur për Media për konfiskimin e pajisjeve transmetuese të ankuesit ishte po ashtu i paligjshëm duke shkelur nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ. Shih PKDNJ, *Nexhmedin Spahiu*, lënda nr. 02/08 (mendim i 26 nëntorit 2010).

112. Në rastin *Kušić*, Paneli theksoi se vendimi detyrues dhe i zbatueshëm i HPCC, krijoi të drejtën qoftë për kompensim apo ripozitim të pronës së pretenduar. Kjo nuk u kundërshtua nga palët. Paneli, pasi mori parasysh praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, theksoi se të drejtat e tilla të krijuara në mënyrë gjyqësore, në këtë rast qoftë e drejta për kompensim apo e drejta për gëzim të plotë të pronës, duhet të konsiderohet “posedim” në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ. Prandaj, koha e zgjatur në zbatimin e vendimit të HPCC nga ana e autoriteteve në favor të ankueses, e shkeli të drejtën e saj për gëzim të papenguar të pronës. Shih PKDNJ, *Nadica Kušić*, lënda nr. 08/07 (mendim i 15 majit 2010).

113. Në rastin *Mitrović*, Paneli theksoi se shtrohet pyetja nëse neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ ishte i zbatueshëm. Koncepti i “pronës” të cilit i referohemi në fjalinë e parë të paragrafit të parë në atë dispozitë ka kuptim autonom. Neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ zbatohet vetëm për pronën ekzistuese të personit. Në rrethana të caktuara, një “pritje legjitime” për marrjen e një “aseti” mund po ashtu të gëzojë mbrojtjen e nenit 1 të Protokollit nr. 1, me kusht që të ketë bazë të mjaftueshme për të shprehur interesim për pronësinë në ligjin në fuqi, për shembull kur kemi praktikë të vendosur gjyqësore të gjykatave që konfirmojnë ekzistimin e tij. Mirëpo, nuk mund të themi se kemi pritje legjitime kur kemi kontest për sa i përket interpretimit dhe zbatimit të saktë të ligjit, dhe kur dihet se parashtresat e ankuesit më vonë u refuzuan nga gjykatat. Në rastin *Mitrović*, HPCC theksoi se ankuesi nuk dëshmoi se ai kishte fituar ndonjëherë posedimin për pasurinë të cilën e pretendonte. Ankesa e ankuesit në esencë përfshinte kundërshtimin e rezultatit dhe rregullsisë së procedurës pranë HPCC. Paneli nuk përjashtoi se UNMIK-u mund të mbahet përgjegjës për efektet e pafavorshme në interesat pronësore të ankuesit të shkaktuara nga vendimi i marrë nga HPCC, nëse vendimi i këtij të fundit do të konsiderohej si arbitrar apo në shikim të parë i paarsyeshëm. Mirëpo, Paneli konstatoi, sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ (lidhur me gjykimin e drejtë), se HPCC dha arsye të mjaftueshme për vendimin e tij dhe se vlerësimi i tij i elementeve të rastit nuk mund të konsiderohej si arbitrar. Prandaj, Paneli konkludoi se ankuesi nuk kishte “pritje legjitime”, bazuar në ligjin në fuqi, për realizimin e pretendimit të

tij për posedim të banesës. U konstatua se nuk ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ. Shih PKDNJ, *Simo Mitrović*, 06/07 (mendim i 17 dhjetorit 2010).

114. Në rastin *Parlić*, Paneli po ashtu theksoi se UNMIK-u do të mund të mbahej përgjegjës për efektin e pafavorshëm në interesat pronësore të ankuesit, të shkaktuar nga vendimi i marrë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, nëse vendimi i kësaj të fundit do të konsiderohej si arbitrar apo në shikim të parë i paarsyeshëm. Mirëpo, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta hetojë këtë çështje më tutje, meqë konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ. Shih PKDNJ, *Radovan Parlić*, lënda nr. 01/07 (mendim i 18 qershorit 2010).

### **6.3.6. Ndalimi i diskriminimit**

115. Një rregull që zbatohet në përgjithësi, edhe pse duket se është neutrale, mund të ketë efektin e trajtimit të njerëzve në mënyrë të ndryshme, *p.sh.* në bazë të prejardhjes së tyre etnike. Kur një grup i njerëzve, për shkak të prejardhjes së tyre etnike, është në pozitë të cenueshme krahasuar me persona që kanë prejardhje tjetër, autoritetet kompetente janë të obliguar t'u kushtojnë kujdes të veçantë nevojave specifike të atij grupi të caktuar. Ky kujdes i veçantë kërkohet edhe në kornizën rregullative edhe në vendimet në rastet e caktuara. Shih PKDNJ *Radovan Parlić*, lënda nr. 01/07 (mendim i 18 qershorit 2010).

116. Në rastin *Parlić*, ankuesi kërkoi të përfshihet në listën e punëtorëve të cilët kishin të drejtë në një pjesë të fitimeve nga privatizimi i ish ndërmarrjeve në pronësi shoqërore. Sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45, ish punëtorët të cilët nuk ishin në listë, megjithatë mund të pretendojnë “se ata do të ishin regjistruar dhe punësuar po të mos i nënshtroheshin diskriminimit”. Ankuesi argumentoi se Dhoma e Posaçme është dashur ta ketë shumë të qartë se për shkak të prejardhjes së tij serbe ai është obliguar ta lëshojë Kosovën, dhe për shkak të diskriminimit ai më nuk ishte i punësuar aty në kohën e privatizimit. Sipas ankuesit, Dhoma e Posaçme nuk pranoi se ankuesi ishte diskriminuar, dhe kështu vetë e shkeli të drejtën për të mos u diskriminuar. Paneli konsideroi se ankuesi në esencë ankohej për dështimin e Dhomës së Posaçme për të korrigjuar një pabarazi ekzistuese, viktimë e së cilës ishin ankuesi dhe ish punëtorë të tjerë serbë. PSSP-ja argumentoi se edhe nëse ankuesi do të kishte qenë i diskriminuar, ky diskriminim do të kishte buruar nga rrethanat e Kosovës pas konfliktit të vitit 1999 dhe nuk do të nënkuptonte ndonjë përgjegjësi të UNMIK-ut, në emër të AKM-së ose të Dhomës së Posaçme. Paneli konstatoi se argumenti i tillë nuk ishte i lidhur me çështjen. Edhe nëse diskriminimi do të rezultonte nga një situatë për të cilën UNMIK-u nuk ishte përgjegjës, kjo nuk e reduktoi obligimin e tij që kujdes të veçantë t'u kushtojë nevojave specifike të ish punëtorëve të zhvendosur në rastet e privatizimit. Shih PKDNJ, *Radovan Parlić*, lënda nr. 01/07 (mendim i 18 qershorit 2010).

## **7. Rekomandimet e Panelit**

117. Në vitin 2010, Paneli miratoi një numër të mendimeve për bazueshmërinë ku konstatoi shkelje të të drejtave të njeriut për të cilat UNMIK-u ishte përgjegjës. Vështirësia që përsëritej ishte çështja se çfarë rekomandimesh duhej bërë në një situatë ku UNMIK-u nuk ka më mundësi të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në vendimet që merreshin në Kosovë. UNMIK-u nuk mund më të ndryshojë legjislacionin kur është e nevojshme (ose sido që të jetë, edhe nëse do ta ndryshonte legjislacionin përkatës, ai nuk mund më të siguronte zbatimin), as nuk mund të urdhëronte autoritetet të sanojnë të metat tjera të identifikuar nga Paneli. Kjo situatë kërkonte që Paneli të jetë në dijeni për kufizimet e tilla derisa i bën rekomandimet që do të

kishin efekt pozitiv në situatën e të drejtave të njeriut të ankuesit që është ndikuar nga një gjendje e tillë.

118. Në disa raste, Paneli rekomandoi kompensim jo-monetar për shkeljen e bërë (shih PKDNJ, *Petko Milogorić, dhe të tjerët*, lëndët me nr. 38/08, 58/08, 61/08, 63/08 dhe 69/08 (mendim i 24 marsit 2010) dhe PKDNNJ, *Nadica Kušić*, lënda nr. 08/07 (mendim i 15 majit 2010), në mes tjerash), kurse në raste të tjera, Paneli pranoi se konstatimi i shkeljes ishte kompensim adekuat për rrethanat (shih PKDNJ, *Gani Emini*, lënda nr. 17/08 (mendim i 18 qershorit 2010)). Në raste të tjera, Paneli rekomandoi që vetë UNMIK-u të pranojë se është bërë shkelje dhe tha se pranimi i tillë do të ishte riparim i mjaftueshëm për rrethanat. (shih PKDNJ, *Nexhmedin Spahiu*, lënda nr. 02/08 (mendim i 26 nëntorit 2010) dhe PKDNJ, *Simo Mitrović*, dhe lëndët me nr. 06/07 (mendim i 17 dhjetorit 2010)).

119. Në raste të tjera, Paneli do të kishte rekomanduar veprime konkrete për UNMIK-un që të rregullojë situatën, po të mos qëndronte fakti se UNMIK-u nuk ishte më në gjendje të ushtrojë mandatin e tij sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 të Kombeve të Bashkuara, pas shpalljes unilaterale të pavarësisë nga autoritetet e Kosovës dhe zhvillimeve të mëtejshme në terren. Duke pranuar faktin se UNMIK-u nuk mund më të ndërmarrë vetvetiu hapat e nevojshëm për rregullimin e një situate, Paneli ka rekomanduar që UNMIK-u të ndajë mendimin e tij me akterët tjerë aktual në atë fushë, thjeshtë për t'i njoftuar ata me mendimin e tij dhe kështu edhe me çështjet të cilat janë objekt i kontestit (shih PKDNJ, *Gani Emini*, lënda nr. 17/08 (mendim i 18 qershorit 2010)), ose në raste të tjera aktivisht të inkurajojë autoritetet kompetente t'i përfundojnë ndryshimet e nevojshme që do të mundësonin rregullimin e situatës (PKDNJ, *Nadica Kušić*, lënda nr. 08/07 (mendim i 15 majit 2010)). Në fakt, në rastin *Kušić* Paneli rekomandoi që UNMIK-u "të bëjë përpjekje, me të gjitha mjetet diplomatike që i ka në dispozicion vis-à-vis autoriteteve të Kosovës, për të marrë garanci se legjislacioni i nevojshëm për ekzekutimin e vendimeve të tilla të HPCC do të shpallet pa vonesa" (shih PKDNJ, *Nadica Kušić*, lënda nr. 08/07 (mendim i 15 majit 2010) § 74). Paneli përdori një formulë të ngjashme në rastin *Milogorić dhe të tjerët*, duke rekomanduar që UNMIK-u "të bëjë përpjekje, me të gjitha mjetet diplomatike që i ka në dispozicion vis-à-vis autoriteteve të Kosovës, për të marrë garanci se ankesat e parashtruara nga ankuesit do të procedohen me kohë" (PKDNJ, *Petko Milogorić, dhe të tjerët*, lëndët me nr. 38/08, 58/08, 61/08, 63/08 dhe 69/08 (mendim i 24 marsit 2010) §52). Në të njëjtën kohë, si në rastin *Kušić* ashtu edhe *Milogorić, dhe të tjerët*, Paneli konstatoi se është e duhur të rekomandojë kompensim adekuat për dëmet jomateriale lidhur me mosekzekutimin e vendimeve në rastet pronësore të ankuesve të paraqitura pranë HPCC.

120. Në çdo ankesë deri më sot në të cilën Paneli ka konstatuar shkelje, Paneli ka rekomanduar që UNMIK-u të ndërmerr masa të menjëhershme dhe efektive për implementimin e rekomandimeve të tij dhe të njoftojë ankuesin dhe Panelin për zhvillimet e mëtejshme për rastin. Implementimi është diskutuar më tutje në pjesën tjetër.

## 8. Reagimi i UNMIK-ut ndaj rekomandimeve të Panelit

121. Pas miratimit të një mendimi për bazueshmërinë në të cilin Paneli konstaton shkelje të të drejtave të njeriut që i atribuohet UNMIK-ut, Paneli ia komunikon atë mendim ankuesit dhe UNMIK-ut. Në komunikatën dërguar UNMIK-ut, Paneli u referohet neneve 17.3 dhe 17.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12. Neni 17.3 parasheh që PSSP-ja të ketë pushtet ekskluziv dhe diskrecion të vendosë nëse do të reagojë për konstatimet e Panelit, derisa me nenin 17.4 kërkohet që vendimet e PSSP-së "të publikohen menjëherë në anglisht, shqip dhe serbisht në mënyrën që siguron shpërndarje të gjerë dhe qasje." Derisa nga korrespondencat e

brendshme të Panelit duket se UNMIK-u përgjithësisht është duke i ndjekur rekomandimet e bëra nga Paneli, është po ashtu e vërtetë se nga 13 mendimet e miratuara nga Paneli, duke konstatuar shkelje të të drejtave të njeriut që kur filloi të jetë funksional, UNMIK-u e ka publikuar vendimin e tij për implementimin e rekomandimeve të Panelit vetëm për një rast. Shih PKDNJ, *Nadica Kušić*, lënda nr. 08/07 (mendim i 15 majit 2010). Kështu që, dymbëdhjetë mendimet e tjera me të cilat është konstatuar shkelje e bazueshmërisë, kanë mbetur pa përgjigje publike nga UNMIK-u, duke përfshirë një mendim që u miratua nga Paneli në vitin 2008 (shih PKDNJ, *Shaip Canhasi*, nr. 04/08 (mendim i 12 nëntorit 2008)). Paneli singërisht shpreson se UNMIK-u ka mundësi t'u japë përgjigje publike këtyre ankuesve në një të ardhme të afërt.

122. Në rastin *Kušić*, lënda nr. 08/07, UNMIK-u lëshoi komunikatën vijuese për shtyp duke iu përgjigjur mendimit të Panelit:

“Pas shqyrtimit të mendimit të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNJ) në rastin *Nadica Kušić*, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm Lamberto Zannier, e informoi PKDNJ më 25 maj 2010 për si vijon lidhur me rekomandimet e tij:

- UNMIK-u do të kërkojë nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX), i cili ka marrë përgjegjësitë në fushën e drejtësisë në Kosovë, të veprojë së bashku me autoritetet relevante të Kosovës për të siguruar ndërmarrjen e të gjitha hapave të nevojshëm për miratimin e masave administrative që janë të nevojshme për ekzekutimin e të gjitha vendimeve të Komisionit të Ankesave për Çështje Banësore Pronësore (HPCC) pa vonesë.
- Rezolutat aktuale të Asamblesë së Përgjithshme të KB-së nuk e lejojnë Organizatën apo misionet e saj të paguajnë kompensim përveç dëmit material apo dëmit fizik. Kështu që UNMIK-u nuk është në pozitë të paguaj kompensim për shkelje të të drejtave të njeriut të cilat mund të jenë bërë. Mirëpo, UNMIK-u do të vazhdojë ta drejtojë çështjen tek selia e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, me qëllim që Asamblesë së Përgjithshme t'ia tërheqë vëmendjen për këtë problem, duke marrë gjithashtu parasysh standardet e të drejtave të njeriut që mbizotërojnë në kontekstin në të cilin vepron UNMIK-u.
- Siç është rekomanduar nga Paneli, UNMIK-u gjithashtu do të informojë ankuesit për zhvillimet e mëtejshme në këtë çështje.”

123. Paneli përshëndet qasjen konstruktive të miratuar nga UNMIK-u në përgjigjen e tij për këtë mendim dhe publikimin e shpërndarjen e tij të menjëhershme. Edhe pse Paneli akoma nuk ka marrë informacione të mëtejshme nga UNMIK-u për zhvillimet në këtë rast, Paneli beson se UNMIK-u do të japë informacione të mëtejshme posa t'i ketë në dispozicion.

124. Mirëpo, pozicioni i UNMIK-ut për çështjen e kompensimit të dëmit jomonetar është se rregulloret përkatëse të Kombeve të Bashkuara dhe rregulloret nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e ndalojnë atë që ankuesve t'u paguaj kompensim në rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Paneli është i vetëdijshëm se pagesa e kompensimit ngrit çështje të ndërlikuara ligjore dhe mbetet me shpresë se kjo mund të zgjidhet në të ardhmen. Në këtë kontekst, Paneli përkujton rekomandimet nga Mendimi i Komisionit të Venecias për mekanizmat ekzistues për rishikimin e përputhshmërisë së akteve të UNMIK-ut dhe EULEX-

it në Kosovë më 21 dhjetor 2010, që sugjeroi disa mënyra kreative që shtyjnë përpara çështjen e kompensimit.

125. Në një situatë tjetër që vlen të përmendet në këtë aspekt, Paneli bëri një sërë rekomandimesh në rastin *Spahiu*, duke përfshirë edhe faktin se UNMIK-u duhet të pranojë se ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ. Shih PKDNJ, *Nexhmedin Spahiu*, lënda nr. 02/08 (mendim i 26 nëntorit 2010). UNMIK-u pastaj i dërgoi një letër ankuesit, duke ia dërguar një kopje edhe Panelit, që më vonë u paraqit në mediat e Prishtinës. Në letër thuhej se UNMIK-u e pranonte se kishte ndodhur një shkelje e tillë dhe tha se së shpejti do të lëshohej një komunikatë për shtyp. Edhe pse komunikata për shtyp akoma nuk është lëshuar, letra e UNMIK-ut dërguar ankuesit ku pranohet se ka pasur shkelje ka pasur një mbulim të gjerë nga mediat e Kosovës.

**Shtojcat**

Shtojca A: Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, më 23 mars 2006

Shtojca B: Urdhëresa administrative e UNMIK-ut nr. 2009/1, për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, e datës 17 tetor 2009

Shtojca C: Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, Rregullorja e Punës, Rregulla 33 (miratuar më 12 shkurt 2010)

Shtojca D: Grafiku i rrjedhës së lëndëve pranë Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut



Shtojca A: Rregulloria e UNMIK –ut No. 2006/12

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies au  
Kosovo

UNMIK/REG/2006/12  
23 March 2006

## RREGULLORE NR. 2006/12

### MBI THEMELIMIN E PANELIT KËSHILLDHËNËS PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke pasur parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Me qëllim të themelimit të Panelit këshilldhënës për të drejtat e njeriut, si organ i përkohshëm gjatë mandatit të UNMIK-ut, për shqyrtimin e shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut nga ana e UNMIK-ut,

Me anë të kësaj shpall Rregulloren në vijim:

#### **KAPITULLI I: Themelimi dhe kompetencat e Panelit këshilldhënës mbi të drejtat e njeriut**

##### Neni 1

##### Themelimi i Panelit këshilldhënës mbi të drejtat e njeriut

1.1 Me këtë themelohet Paneli këshilldhënës mbi të drejtat e njeriut (Paneli këshilldhënës)

1.2 Paneli këshilldhënës shqyrton ankesat e çdo personi apo grupit të personave të cilët

pohojnë se janë viktime të shkeljes së të drejtave të njeriut nga UNMIK-u sikur që është dhënë në një rën apo në më shumë instrumentet vijuese:

- (a) Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e datës 10 dhjetor 1948;
- b) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të datës 4 nëntor 1950 bashkë me Protokollet e saj;
- (c) Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike e datës 16 dhjetor 1966 bashkë me Protokollet e saj;
- (d) Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e datës 16 dhjetor 1966;
- (e) Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor e datës 21 dhjetor 1965;
- (f) Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave e datës 17 dhjetor 1979;
- (g) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore apo Degraduese e datës 17 dhjetor 1984 dhe
- (h) Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve e datës 20 dhjetor 1989.

1.3 Pas përfundimit të shqyrtimit të një ankese, Paneli këshilldhënës ia dërgon konkluzionet e veta Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm. Konkluzionet e Panelit këshilldhënës, të cilat mund të përfshijnë rekomandime janë të natyrës këshilldhënëse.

## Neni 2

### Kompetencat e përkohshme dhe territoriale

Paneli këshilldhënës ka kompetenca në gjithë territorin e Kosovës dhe për ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e supozuara të të drejtave të njeriut që janë bërë pas datës 23 prill 2005 apo që kanë rrjedh nga faktet e paraqitura para kësaj date dhe që këto fakte rrisin në vazhdimësi shkeljen e të drejtave njerëzore.

## Neni 3

### Kriteret për pranimin e ankesës

3.1 Paneli këshilldhënës mund të trajtojë një çështje vetëm pasi të ketë konkluduar se janë ndjekur të gjitha rrugët tjera të mundshme për shqyrtimin e shkeljes së supozuar dhe brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh nga data kur është marrë vendimi i formës së prerë.

3.2 Paneli këshilldhënës nuk shqyrton ankesën që është:

- (a) anonime ose

(b) kryesisht e njëjtë me një çështje që tanimë është shqyrtuar nga Paneli këshilldhënës dhe nuk përmban informata të reja përkatëse.

3.3 Paneli këshilldhënës shpall si të papranueshme çdo ankesë të cilën e konsideron se nuk është në përputhshmëri me të drejtat e njeriut, të përcaktuara në një apo në më shumë instrumente të përmendura në nenin 1.2 lart dhe e konsideron si të pabazë ose shpërdorim i së drejtës së ankesës.

## **KAPITULLI 2: Përbërja dhe statusi i Paneli këshilldhënës mbi të drejtat e njeriut**

### Neni 4

#### Selia dhe përbërja

4.1 Paneli këshilldhënës e ka selinë në Prishtinë.

4.2 Paneli këshilldhënës përbëhet prej tre anëtarëve nga të cilët njëri emërohet kryesues. Së paku një anëtar i Panelit këshilldhënës duhet të jetë femër.

4.3 Anëtarët e Panelit këshilldhënës janë juristë ndërkombëtarë me karakter të lartë moral, paanshmëri dhe integritet, të dëshmuar si ekspertë në fushën e të drejtave të njeriut, në veçanti në sistemin evropian.

### Neni 5

#### Emërimi i anëtarëve

5.1 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm emëron anëtarët e Panelit këshilldhënës pas propozimit të bërë nga Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

5.2 Anëtarët emërohen me mandat dy (2) vjeçar. Emërimi mund të vazhdohet edhe për një mandat tjetër dyvjeçar (2).

### Neni 6

#### Dhënia e betimit solemn

Me rastin e emërimit, çdo anëtar i Panelit këshilldhënës e nënshkruan deklaratën në vijim para Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm ose para personit të caktuar nga ai:

“Solemnisht deklaroj se:

“Do t’i përmbahem ligjit gjatë gjithë kohës së ushtrimit të funksioneve në postin tim dhe do të veproj në pajtim me standardet më të larta profesionale e respektin më të lartë ndaj dinjitetit të postit tim dhe detyrave që më janë besuar.

Në ushtrimin e funksioneve të postit tim gjithmonë do të mbështes standardet më të larta të pranuara ndërkombëtarisht mbi të drejtat e njeriut, përfshirë ato të paraqitura në parimet e Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut, në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut bashkë me Protokollet e saj, në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike bashkë me Protokollet e saj, në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, në Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, në Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore apo Degraduese dhe në Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve”.

#### Neni 7

##### Imuniteti dhe pacenueshmëria

7.1 Zyrat e shfrytëzuara nga Paneli këshilldhënës janë të pacenueshme. Arkivi, lëndët, dokumentet, komunikimet, prona, fondet dhe pasuritë e Panelit këshilldhënës kudo që të vendosen dhe nga kushdo që të mbahen janë të pacenueshme dhe të mbrojtura nga bastisja, marrja, sekuestrimi, konfiskimi, shpronësimi ose nga çfarëdo forme tjetër e ndërhyrjes përmes veprimit ekzekutiv, administrativ, gjyqësor a legjislativ.

7.2 Anëtarët e Panelit këshilldhënës kanë imunitet të njëjtë si personeli i UNMIK-ut sipas neneve 3.3 dhe 3.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/47 mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë.

7.3 Sekretari i Përgjithshëm ka të drejtë dhe përgjegjësi t’ia heqë imunitetin e anëtarit të Panelit këshilldhënës në çdo rast që, sipas mendimit të tij, imuniteti do të pengojë rrjedhat e drejtësisë dhe ai mund të hiqet pa cenuar interesat e UNMIK-ut.

#### Neni 8

##### Burimet financiare dhe njerëzore

Për funksionimin efikas të Panelit këshilldhënës merren masat e duhura përmes sigurimit të burimeve të nevojshme financiare dhe njerëzore.

#### Neni 9

##### Sekretariati

Panelit këshilldhënës ka sekretariatit me orar të plotë.

### **KAPITULLI 3: Procedura e punës së Panelit këshilldhënës mbi të drejtat e njeriut**

Neni 10Parashtrimi i ankesave dhe përfaqësuesit sipas detyrës zyrtare

12.1 Komunikimet ndërmjet Panelit këshilldhënës dhe ankuesit ose personit që vepron në emër të tij janë të fshehta.

12.2 Fshehtësia e komunikimit siç paraqitet në nenin 12.1 zbatohet në tërësi kur ankuesi ose personi që vepron në emër të tij është në paraburgim.

Neni 11Parashtrësit me shkrim

11.1 Ankesa paraqet të gjitha faktet e rëndësishme mbi të cilat bazohet shkelja e supozuar e të drejtave të njeriut. Ankesës mund t'i bashkëngjiten edhe dokumente të tjera si dëshmi.

11.2 Pas marrjes së ankesës Paneli këshilldhënës përcakton se a është ankesa e pranueshme. Nëse informacionet e dhëna me ankesën nuk mundësojnë që të bëhet një konstatim i tillë, Paneli këshilldhënës kërkon informacione shtesë nga ankuesi. Nëse Paneli këshilldhënës konstaton se ankesa është e papranueshme, ai merr vendim me të cilin refuzohet ankesa.

11.3 Kur Paneli këshilldhënës konstaton se ankesa është e pranueshme, ai ia referon ankesën Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në mënyrë që të merret një përgjigje në emër të UNMIK-ut lidhur me ankesën. Përgjigjja e tillë i jepet Panelit këshilldhënës brenda njëzet (20) ditësh nga dita e pranimit të ankesës nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

11.4 Paneli mund të kërkojë nga ankuesi dhe UNMIK-u që të bëjnë parashtrësia tjera me shkrim brenda afateve kohore që ai mund t'i caktojë nëse këto parashtrësia janë në interes të drejtësisë.

Neni 12Fshehtësia e komunikimeve

12.1 Komunikimet ndërmjet Panelit këshilldhënës dhe ankuesit ose personit që vepron në emër të tij janë të fshehta.

12.2 Fshehtësia e komunikimit siç paraqitet në nenin 12.1 zbatohet në tërësi kur ankuesi ose personi që vepron në emër të tij është në paraburgim.

Neni 13Pjesëmarrja e një Amicus Curiae dhe e avokatit të popullit

13.1 Paneli këshilldhënës, kur është në interes të drejtësisë, mund të ftojë

(a) Një *amicus curiae* që të parashtrorjë komentet me shkrim dhe

(b) Avokatin e popullit që të parashtrorjë komentet me shkrim nëse ai është duke u marrë me këtë çështje.

13.2 Parashtrësas me shkrim nga avokati i popullit do të jenë pa paragjykime mbi autorizimet, përgjegjësitë dhe obligimet e avokatit të popullit sipas ligjit në fuqi.

Neni 14 Seancatverbale

Kur është në interes të drejtësisë Paneli këshilldhënës mban seanca verbale.

Neni 15Kërkesat për paraqitjen e personave ose për parashtrimin e dokumenteve

15.1 Paneli këshilldhënës mund të kërkojë paraqitjen e çdo personi, përfshirë edhe personelin e UNMIK-ut, ose parashtrimin e çdo dokumenti, përfshirë dosjet dhe dokumentet që i posedon UNMIK-u, të cilat mund të jenë të rëndësishme për ankesën.

15.2 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm bashkëpunon me Panelin këshilldhënës dhe i ofron atij ndihmën e nevojshme gjatë ushtrimit të pushtetit dhe kompetencave të tij në mënyrë të vaçantë për lëshimin e dokumenteve dhe informatave që janë të rëndësishme për ankesën..

15.3 Kërkesat për paraqitjen e personelit të UNMIK-ut ose për parashtrimin e dokumenteve të Kombeve të Bashkuara i bëhen Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm. Gjatë marrjes së vendimit për t'iu përgjigjur këtyre kërkesave Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm merr parasysh interesin e drejtësisë, promovimin e të drejtave të njeriut dhe interesat e përgjithshme të UNMIK-ut e të Kombeve të Bashkuara.

### Neni 16

#### Seancat publike dhe qasja në dokumentet e deponuara në Panelin këshilldhënës

16.1 Seancat e Panelit këshilldhënës janë publike përveç në rastet e jashtëzakonshme kur Paneli këshilldhënës vendos ndryshe.

16.2 Pas miratimit nga Paneli këshilldhënës, dokumentet e deponuara në Panelin këshilldhënës për të drejtat e njeriut mund t'i vëhen në dispozicion çdo personi që ka interes të ligjshëm në çështjen pas paraqitjes së kërkesës me shkrim.

### Neni 17

#### Konkludimet dhe rekomandimet e Panelit këshilldhënës

17.1 Paneli këshilldhënës sjell konkludimet mbi atë se a ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut dhe, kur është e nevojshme, bën rekomandime. Këto konkludime dhe çdo rekomandim i Panelit këshilldhënës i parashtrihen Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

17.2 Konkludimet dhe rekomandimet e Panelit këshilldhënës botohen me kohë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe në mënyrën që siguron shpërndarje të gjërë dhe qasje në to.

17.3 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm ushtron pushtetin dhe diskrecionin ekskluziv për të vendosur se a duhet vepruar sipas konkludimeve të Panelit këshilldhënës.

17.4 Vendimet e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm botohen me kohë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe në mënyrën që siguron shpërndarje të gjërë dhe qasje në to.

### Neni 18

#### Rregullorja e punës

18.1 Paneli këshilldhënës miraton rregulloren e punës për procedurat e veta. Rregullorja e punës mund t'i jepë autorizime dhe përgjegjësi sekretariatit të Panelit këshilldhënës.

18.2 Pas miratimit nga Paneli këshilldhënës, rregullorja e punës publikohet me kohë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe me qëllim të shpërndarjes së gjërë dhe qasjes në to.

## **KAPITULLI 4: Dispozitat përfundimtare**

### Neni 19 Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të shpallë çdo udhëzim të nevojshëm administrativ për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

### Neni 20 Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

### Neni 21 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 23 mars 2006, përveç nenit 10 i cili hyn në fuqi me 23 prill 2006.

Søren Jessen-Petersen Përfaqësues Special i  
Sekretarit të Përgjithshëm



Shtojca B: Urdhëresa administrative e UNMIK-ut nr. 2009/1

**UNITED NATIONS**  
United Nations Interim  
Administration Mission in  
Kosovo



UNMIK

**NATIONS UNIES**  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations  
Unies au  
Kosovo

UNMIK/DIR/2009/1  
17 October 2009

**URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2009/1**

**PËR IMPLEMENTIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UR NR. 2006/12 MBI  
THEMELIMIN E PANELIT KËSHILLËDHËNËS PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP),

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me nenin 19 të Rregullores nr. 2006/12 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), të datës 23 mars 2006 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2007/3, të datës 12 janar 2007 (Rregullorja),

Duke marrë parasysh Rregulloren e Punës të miratuar më 5 shkurt 2008 nga Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, në pajtim me nenin 18 të Rregullores,

Me qëllim të qartësimit të karakterit dhe rregullimit të procedurave të dëgjimeve publike të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, shqyrtimin e pranueshmërisë së ankesave nga ky Panel dhe caktimin e një afati kohor për paraqitjen e ankesave pranë këtij Paneli, Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, duke pasur parasysh kapacitetin e zvogëluar të UNMIK-ut që të ushtrojë autoritet ekzekutiv në mënyrë efektive në të gjitha fushat nga ku burojnë çështjet e ankesave për të drejtat e njeriut,

Me anë të kësaj nxjerr këtë Urdhëresë administrative,

Neni 1  
Dëgjimet publike

1.1 Dëgjimet publike të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (Paneli Këshillëdhënës) do të drejtohen në mënyrën dhe përbërjen që qartazi do të lënë të kuptohet se janë procedura joadversiale dhe që do t'ju përcillen të gjithë pjesëmarrësve si dhe opinionit të gjerë publik, duke përfshirë edhe mediat e pranishme, nëse prania e tyre lejohet nga Paneli Këshillëdhënës.

1.2 Gjatë dëgjimeve publike, ankuesve apo përfaqësuesve të tyre do t'ju lejohet të bëjnë deklarata duke përmbledhur pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut, ashtu siç është paraqitur në parashtrësën me shkrim pranë Panelit Këshillëdhënës. Gjatë dëgjimeve publike, Paneli Këshillëdhënës mund t'ju parashtrrojë pyetje palëve ose përfaqësuesve të tyre të cilat qartësojnë bazën faktike të ankesës, dhe që për Panelin Këshillëdhënës janë të nevojshme që në tërësi të vlerësojë pohimin për shkeljen e të drejtave të njeriut të paraqitur pranë tij.

1.3 Vendi dhe rregullimi i ulëseve për dëgjimet publike të drejtuara nga Paneli Këshillëdhënës janë në përputhje me natyrën joadversiale të procedurës.

## Neni 2

### Çështjet e pranueshmërisë

2.1 Në cilëndo fazë të procedurës së një ankese mbi të drejtat e njeriut të paraqitur pranë tij, Paneli Këshillëdhënës shqyrton të gjitha çështjet e pranueshmërisë së ankesës para se të shqyrtojë bazueshmërinë e rastit.

2.2 Çdo ankesë e cila është apo mund të jetë në të ardhmen çështje e procesit të ankesave të palës së tretë ose procedurave sipas nenit 7 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/47 mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë, të datës 18 gusht 2000, do të konsiderohet e papranueshme për arsye se procesi i ankesave të palës së tretë të KB-së dhe procedura sipas nenit 7 të Rregullores nr. 2000/47 janë mjete në dispozicion sipas nenit 3.1 të Rregullores.

2.3 Pas çdo vendimi të ri mbi pranueshmërinë e rastit, Paneli Këshillëdhënës vendimin e tillë të ri ia referon Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm me qëllim të marrjes së komenteve shtesë për ankesën.

## Neni 3

### Emërimi dhe dorëheqja e anëtarëve të Panelit

3.1 Kryetari i Gjykatës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut do të propozojë një numër të mjaftueshëm të kandidatëve të përshtatshëm për emërim sipas nenit 5 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2006/12, në pajtim me rregullat e zbatueshme të prokurimit të KB-së, pas marrjes së kërkesës nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Nëse UNMIK-u nuk merr asnjë propozim apo merr numër të pamjaftueshëm të propozimeve brenda një muaji kalendarik nga kërkesa e tillë, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të bëjë emërimin e nevojshëm pa propozimin e kërkuar dhe pas konsultimeve me organet relevante ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.

3.2 Nëse një apo më shumë anëtarë të Panelit Këshillëdhënës japin dorëheqje nga postet e tyre, Paneli nuk merr asnjë vendim derisa të bëhen emërimet e reja duke ia mundësuar Panelit të arrijë numrin e parashikuar të anëtarëve.

Neni 4  
Publikimet e Panelit Këshillëdhënës

Të gjitha publikimet, njoftimet dhe komunikatat për shtyp të Panelit Këshillëdhënës bëhen përmes zyrës së zëdhënësit të UNMIK-ut dhe informimit publik, që e ndihmon Panelin Këshillëdhënës në njoftimet e tij zyrtare mbi të gjitha çështjet.

Neni 5  
Data e prerë për parashtrimin e ankesave

Pavarësisht nga neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, asnjë ankesë dorëzuar Panelit Këshillëdhënës nuk do të jetë e pranueshme nëse pranohet nga Sekretariati i Panelit Këshillëdhënës më vonë se 31 mars 2010.

Neni 6  
Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi më 17 tetor 2009 dhe është e zbatueshme për të gjitha ankesat e dorëzuara Panelit Këshillëdhënës, duke përfshirë edhe ato të cilat janë në pritje për t'u shqyrtuar nga Paneli Këshillëdhënës.

Lamberto Zannier  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Shtojca C: Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, Rregullorja e Punës, Rregulla 29bis dhe Rregulla 39bis

Rregulla 29bis (miratuar më 11 shtator)

*Rregulla 29bis. Vendimi për pranim pa ia komunikuar ankesën UNMIK-ut*

Paneli mund gjithashtu të deklarojë menjëherë se ankesa është e pranueshme, kur në ankesë ngriten çështje që në esencë janë të njëjta sikurse ato të ngritura në ankesa të tjera, të cilat tanimë janë shpallur të pranueshme nga Paneli, dhe kur nuk ngriten çështje të reja të pranueshmërisë.

Rregulla 39bis (miratuar më 30 nëntor 2009)

*Rregulla 39bis. Kërkesat për kufizime në zbulimin e dëshmive*

1. Çilado palë mund të kërkojë nga Paneli të mos i zbulojë palës tjetër në procedurë dëshmitë që i ka paraqitur ajo, për të mbrojtur një interes të rëndësishëm publik ose për të mbrojtur të drejtat fundamentale të ankuesit apo të ndonjë personi tjetër në fjalë. Çilado kërkesë e tillë do të përfshijë arsyet dhe do të specifikojë nëse kërkon kufizimin e zbulimit të tërë informacionit të paraqitur apo vetëm një pjese të tij. Paneli vendos për kërkesën në bazë të njëjës palë (*ex parte*).

2. Nëse Paneli e miraton kërkesën, ai e njofton palën tjetër për vendimin e tij dhe vepron në përputhje me rrethanat. Për aq sa nuk e rrezikon karakterin konfidencial të informacionit të pranuar, Paneli tregon llojin e dëshmive të pranuar në fshehtësi. Paneli ka mundësi që vendimet e veta t'i bazoj në dëshmi të pranuar në fshehtësi.

Nëse Paneli nuk e miraton kërkesën, ose nëse e miraton vetëm pjesërisht, palën kërkuese e njofton për vendimin e tij, dhe asaj i jep mundësinë që të rishqyrtojë çështjen e parashtrimin të dëshmive pranë Panelit.

**Shtojca D:Grafiku i rrjedhës së lëndëve pranë Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut**

